

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 58/00, 44/02, 82/08,167/10,51/11, 96/2019 и 110/2019) и член 22 став 1 од Законот за средно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 и 64/18), и член 3 од Законот за математичко-информатичка гимназија („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 64/18) министерот за образование и наука ја донесе Наставната програма по предметот Албански јазик и литература за I (прва) година математичко-информатичка гимназија.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT



Programi mësimor

**GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI**

**Për vitin I**

**Gjimnazi matematiko-informatik**

Shkup 2020

Emri i programit mësimor	Gjuhë shqipe dhe letërsi
Lloji i programit mësimor	Obligativ
Vlera e kreditit e programit mësimor	5 (pesë) ECVET kredite
Niveli i kualifikimit	Niveli IV (i katërt)
Viti mësimor	I (i parë)
Numri i orëve javore/vjetore për realizimin e programit mësimor	3/108
Qëllimet e programit mësimor	<p><b>Nxënësit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të zgjerojnë dhe të përthellojnë njohuritë për gjuhën standarde shqipe si mjet për komunikim;</li> <li>- të zgjedhin, të rezimojnë dhe të zbatojnë dituritë e arritura në kontestin gjuhësor përkatës;</li> <li>- të paraqesin hierakinë dhe lidhshmërinë e njësive gjuhësore nga fonema deri te fjalia dhe të potencojnë rëndësinë e tyre në komunikimin gjuhësor;</li> <li>- të zbatojnë në të shprehurit me gojë dhe me shkrim rregullat gjuhësore dhe konstrukcionet karakteristike për gjuhën standarde shqipe;</li> <li>- të zbatojnë shkathhtësitë për analizë dhe interpretim të pavarur të veprave letrare nga autorë, epoka dhe drejtime të ndryshme;</li> <li>- të aftësohen që në mënyrë kritike dhe me argumente të vlerësojnë veprat letrare, situatat problemore, manifestimet shoqërore, kulturore e artistike dhe evenimentet përmes qëndrimeve dhe mendimeve vetjake.</li> </ul>
Njësi modulare të programit mësimor	<ul style="list-style-type: none"> <li>• GJUHË</li> <li>• LETËRSI</li> </ul>

	<p><i>Shënim: Modulet <b>Gjuhë dhe Letërsi</b> gjejmësisht përmbajtjet në të dy modulet duhet të kombinohen ndërmjet veti. Me këtë do të arrihet tërësia në raport me qëllimet e përgjithshme të lëndës si dhe arritja e rezultateve të parashikuara sipas kritereve të dhëna. Çdo orë mësimore edhe mëtutje do të ketë qëllimin e vet, i cili do të kombinohet me përmbajtjet tanimë të mësuara nga njëri apo tjetri modul. Njëkohësisht ju sugjerojmë se orari dhe organizimi i mirë i përmbajtjeve të dhëna do të ndikon në realizimin e orëve, gjejmësisht do të ndikon në suksesin e nxënies në mësim.</i></p>
<p><b>Kushtet tekniko-materiale dhe hapsinore</b></p>	<p>Për arritjen e qëllimeve në lëndën mësimore gjuhë shqipe dhe letërsi duhet të sigurohen mjete mësimore në kabinete ose mësojtore, fond i librave për bibliotekë, akses – qasje në internet, paisje kompjutorike, LCD projektor etj. Për realizim të plotë dhe të suksesshëm të programit mësimor duhet të organizohen edhe aktivitete që e ndërrojnë vendin e realizimit të orës/orëve mësimore (institucione të kulturës, manifestime dhe festivale: letrare, teatrore dhe filmike).</p>
<p><b>Normativi për kuadrin mësimor</b></p>	<p>Programin mësimorë e realizojnë mësimdhënësit që kanë kryer:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fakultetin Filologjik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor) VII/1 , 240 kredi</li> <li>2. Fakultetin Filozofik, Grupin e Gjuhës dhe letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor) VII/1 , 240 kredi</li> </ol>

## Njësia modulare: GJUHË

Nr. rendor	Rezultatet nga të nxënit	Përmbajtjet dhe nocionet	Veprimtaritë dhe metodat	Kriteret e vlerësimit*
1	<b>Gjuhësi</b>			
1.1	<p><b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë:</b></p> <p>-të shpjegojë konceptin për komunikimin dhe t'i dallojë llojet e ndryshme të komunikimit;</p> <p>-të dijë funksionin e gjuhës për të komunikuar; të bëjë krahasimin mes gjuhës së sajuar e gjuhës natyrore dhe të dialektit e gjuhës standarde;</p> <p>-ta dallojë dhe ta vlerësojë në mënyrë kritike funksionin e gjuhës si mjet komunikimi;</p> <p>-t'i veçojë, t'i përshkruajë e t'i mbledhë në fund veçoritë e komunikimit në variantin</p>	<p><b>Gjuhësia:</b></p> <p>Kumtimi (komunikimi) - Llojet e komunikimit Gjuha si një sistem shenjash;</p> <p>Gjuha e sajuar dhe gjuha natyrore;</p> <p>Gjuha dialektore dhe gjuha standarde</p> <p><b>Nocionet:</b> Komunikimi (në një drejtim/i ndërsjellë, verbal/joverbal, me sinjale/me simbole)</p> <p>Shenja Simboli Sinjali Semiologjia Dialekti</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b></p> <p>Nxitet një bisedë në klasë, ku duhet të marrë pjesë secili nxënës, shpjegohen veçoritë dhe u kumtohen njohuritë, jepen qëndrime kritike individuale dhe të grupit, nxirren përfundime për komunikimin si koncept dhe si veprimtari me rëndësi individuale e shoqërore.</p> <p>Nëpërmjet punës në grup dhe nga dy veta, duke iu përmbajtur rregullave të mirësjelljes, nxënësit duhet të nxitin / të fillojnë ose të marrin pjesë në komunikimin me gojë a me shkrim për tema që lidhen me shprehitë, nevojat dhe interesat e tyre të përditshme si dhe rreth situatave të përfytyruara të komunikimit nga profesioni i tyre në të ardhmen.</p> <p>Gjatë punës individuale, në grup dhe nga dy veta nxënësit njohin, klasifikojnë, formulojnë, grupojnë e krahasojnë veçoritë dhe sjellin</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mundet:</b></p> <p>1.1.1. ta përkufizojë konceptin <i>komunikim</i> dhe t'i njohë, t'i krahasojë e t'i shpjegojë veçoritë e llojeve të ndryshme të komunikimit dhe llojet e ndryshme të gjuhëve;</p> <p>1.1.2. të përmendë shembuj për llojet e ndryshme të komunikimit dhe për llojet e ndryshme të gjuhëve;</p> <p>1.1.3. të nxitë e të fillojë një bisedë dhe një korrespondencë me shkrim në gjuhë standarde ose në dialekt, të marrë pjesë në një komunikim me gojë a me shkrim, ta vijojë e ta përfundojë ose të shkëputet nga komunikimi në situata të ndryshme komunikimi duke iu përmbajtur</p>

\* Janë përfshirë standardet/indiktorët për arritjen e rezultateve nga të nxënit sipas të cilëve përcaktohen kriteret e vlerësimit.

	standard dhe në atë dialektor.		shembuj për llojet e ndryshme të gjuhëve. <b>Metodat:</b> metoda e ndërveprimit (interaktive) metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e krahasimit.	rregullave të mirësjelljes.
--	--------------------------------	--	---	-----------------------------

2	<b>Zhvillimi historik i gjuhës shqipe</b>			
2.1	<p><b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë:</b></p> <p>-ta dijë vendin që zë gjuha shqipe në familjen e gjuhëve indoevropiane dhe prejardhjen e saj;</p> <p>-t'i identifikojë e t'i shpjegojë veçoritë e gjuhës shqipe dhe afërsitë e dallimet e saj me gjuhët e tjera, si dhe në kontekst me gjuhët ballkanike.</p>	<p><b>Gjuha shqipe në familjen e gjuhëve indoevropiane dhe prejardhja e saj nga ilirishtja</b></p> <p>Disa veçori të përbashkëta të gjuhës shqipe dhe gjuhëve të tjera ballkanike – prirjet zhvillimore drejt analitizmit, përdorimi i nyjave shquese, rimarrja e kundrinorit me trajtat e shkurtra, ndërtimi i kohës së ardhme me format e foljes <i>dua</i>, ndërtimi i formave foljore të përbëra me foljet <i>jam</i> e <i>kam</i>, format mbiemërore analitike të krahasores e të sipërores, etj.</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b></p> <p>Me anë të punës individuale, në grup dhe nga dy veta nxënësit i njohin dhe i përmendin grupet e gjuhëve indoevropiane dhe përcaktojnë vendin e gjuhës shqipe midis gjuhëve të tjera, bëjnë klasifikimin e gjuhëve dhe sjellin shembuj nga gjuha shqipe si gjuhë indoevropiane bijë e ilirishtes.</p> <p>Gjejnë e përmendin fjalë të shqipes me prejardhje indoevropiane e ilire (emra, folje, numërorë; emra vendesh, qytetesh).</p> <p><b>Metodat:</b> metoda e ndërveprimit; metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim);</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mundet:</b></p> <p>2.1.1. të bëjë klasifikimin e gjuhëve indoevropiane dhe t'i përmendë veçori të e përgjithshme të disa grupeve kryesore të kësaj familjeje;</p> <p>2.1.2. të thotë, të sqarojë e të japë shembuj me fjalë shqipe me burim indoevropian e ilir (disa emra, folje, numërorë; disa emra qytetesh e vendesh).</p>

2	Zhvillimi historik i gjuhës shqipe			
		<b>Nocionet:</b> Veçoritë e gjuhës shqipe	metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e krahasimit.	
2.2	-të shpjegojë të dhënat historike për paraqitjen e shkrimeve të para në gjuhën shqipe; -të identifikojë e të dallojë se në ç'dialekt janë shkruar këto dëshmi shkrimore; -të tregojë rrugën e zhvillimit të gjuhës shqipe gjatë periudhës para Rilindjes Kombëtare.	<b>Dëshmitë e para shkrimore të gjuhës shqipe:</b> Veprat e para të botuara në gjuhën shqipe me autorë Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Pjetër Bogdani, Jul Variboba  <b>Konceptet:</b> Shqipe e vjetër Arbërishte Meshar Shkrim liturgjik Katekizëm	<b>Veprimtaritë:</b> Me anë formash të ndryshme të mësimdhënies nxënësit njihen e përballen me veçoritë e zhvillimit historik të gjuhës shqipe në fillimet e shkrimit të saj Nxënësit nxiten që të bëjnë dallimin e shkrimeve të para nga pikëpamja e gjuhës në të cilën janë shkruar  Duke prezantuar tekste të shkurtra nga veprat e para të shkruara shqip nxënësit njihen nga afër me gjuhën e vjetër shqipe.  <b>Metodat:</b> metoda diakronike; metoda audio-vizuale; metoda e ndërveprimit; metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e krahasimit.	2.2.1. të memorizojë faktet për zhvillimin e shkrimeve të para në gjuhë shqipe; 2.2.2. të krahasojë llojet e ndryshme të shkrimeve shqip dhe t'i radhitë ngjashmëritë dhe dallimet e tyre; 2.2.3. të thotë e të shpjegojë të dhënat lidhur me rëndësinë e shkrimeve të para shqipe dhe karakterin e tyre.
3	Fonetika dhe fonologjia			

2	Zhvillimi historik i gjuhës shqipe			
3.1	<p>-të dallojë e të përkufizojë fonetikën dhe fonologjinë si dy degë të afërta të gjuhësisë;</p> <p>-të përcaktojë prejardhjen dhe kuptimin e fjalëve <i>fonemë, fonetikë e fonologji</i>;</p> <p>-të identifikojë e të shpjegojë ngjashmëritë dhe dallimet midis tingullit dhe fonemës dhe midis tingullit e shkronjës;</p> <p>- të arsyetojë ndërlidhjen e fonetikës e fonologjisë me drejtshqiptimin (ortoepinë) dhe drejtshkrimin (ortografinë).</p>	<p><b>Fonetika dhe fonologjia</b></p> <p><b>Nocionet:</b> Struktura e gjuhës Rrafshi gjuhësor /nënsistemi Fonetika Fonologjia Drejtshqiptimi (ortoepia) Drejtshkrimi (ortografia) Tingulli Fonema Shkronja</p>	<p><b>Aktivitetet:</b> Si veprimtari përgatitore nxënësit bëjnë hulumtim për të gjetur prejardhjen e dhe domethënien e fjalëve: <i>fonemë, alofon, grafemë, fonetikë, fonologji, ortoepi dhe ortografi</i>, duke u mbështetur në burime shkencore (të botuara ose elektronike) që ua rekomandon mesimdhënësi. Me këtë veprimtari përgatitore vihet në pah rëndësia e shfrytëzimit të literaturës adekuate dhe profesionale; Ora mund të fillohet në mënyrë deduktive me disa të dhëna të përgjithshme që kanë të bëjnë edhe me njohuritë paraprake për tingujt. Pastaj mund të vazhdohet në mënyrë induktive dhe nëpërmjet analizës dhe përjasjes nxirren përfundime lidhur me rëndësinë që kanë tingujt për ndërtimin e fjalëve dhe të njësive më të mëdha se ajo.</p> <p><b>Metodat:</b> metoda audio-vizuale; metoda audio-linguistike; metoda kërkimore; metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit;</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mundet:</b></p> <p>3.1.1 të sqarojë prejardhjen dhe domethënien e fjalëve: <i>fonemë, alofon, grafemë, fonetikë, fonologji, ortografi dhe ortografi</i> dhe t'i tregojë burimet e të dhënave të botuara dhe elektronike;</p> <p>3.1.2. të shtjellojë dallimet midis tingullit dhe fonemës si dhe midis tingullit dhe shkronjës;</p> <p>3.1.3. të hetojë variantet e tingujve brenda një fjale a disa fjalësh të ndryshme, të japë sqarime për shkaqet e nyjetimit të një tingulli në mënyra të ndryshme dhe të përmendë shembujt përkatës.</p>



2	Zhvillimi historik i gjuhës shqipe			
			metoda e analizës dhe sintezës.	
3.2	<p>-t'i përmendë zanoret dhe bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe dhe t'i thotë kriteret për ndarjen e tillë të tingujve;</p> <p>-të dallojë shqiptimin e drejtë nga shqiptimi jo i drejtë i tingujve; t'i shqiptojë si duhet të gjithë tingujt;</p> <p>-të bëjë ndarjen e tingujve zanorë sipas lëvizjes së gjuhës para-prapa dhe lart-poshtë;</p> <p>- të klasifikojë bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe sipas <i>mënyrës së formimit</i>(llojit të pengesës), sipas <i>organit aktiv</i> dhe sipas <i>pjesëmarrjes së zërit dhe të zhurmës</i>;</p> <p>-të identifikojë rrokjen te fjalët shumërokëshe dhe të tregojë cilët tinguj janë rrokjeformues.</p>	<p><b>Klasifikimi i tingujve të gjuhës shqipe</b></p> <p><b>Nocionet:</b> Zanore Bashkëtingëllore Zanore të radhës së përparme, të radhës së prapme dhe të radhës së mesme Zanore të ngritjes së lartë, të ngritjes së ulët dhe zanore të ngritjes së mesme Bashkëtingëllore mbylltore, shtegore dhe dridhëse Bashkëtingëllore buzore dhe gjuhore Bashkëtingëllore të zhurmëta dhe të tingullta (sonante) Rrokje Tinguj rrokjeformues</p>	<p><b>Aktivitetet:</b> Veprimtaritë mësimore konkretizuese gjatë këtyre orëve përqendrohen te ana tingullore e gjuhës dhe realizohen kryesisht nëpërmjet të folurit dhe fare pak me të shkruar; vendin qendror këtu e zë prodhimi i tingujve, pra paraqitja e mënyrës si njëtohen tingujt me anën e aparatit të të folurit. Zakonisht mund të përdoren edhe mjete auditive të konkretizimit me qëllim ilustrimi të shqiptimit të drejtë të tingujve dhe të leximit normativ, të bukur dhe shprehës. Mësimdhënësi i ndjek me vëmendje veprimtaritë e nxënësve dhe ndërhyr sa herë që ka nevojë. Shqiptimi normativ dhe korrekt i mësimdhënësit duhet të jetë mjeti i pakontestueshëm konkretizues gjatë këtyre orëve.</p> <p>Bëhet përshkrimi i aparatit të të folurit dhe funksioni i organeve të të folurit për prodhimin e tingujve të ligjërit.</p> <p><b>Metodat:</b> metoda audio-vizuale; metoda audio-linguistike; metoda e ndërveprimit;</p>	<p>3.2.1. të përshkruajë e të tregojë mënyrën e nyjëtimin dhe shqiptimin normativ të tingujve;</p> <p>3.2.2. t'i thotë zanoret dhe bashkëtingëlloret dhe i shpjegon kriteret për ndarjen e tyre;</p> <p>3.2.3. të bëjë ndarjen e zanoreve sipas lëvizjes horizontale dhe pingule të gjuhës;</p> <p>3.2.4. të tregojë grupet e bashkëtingëlloreve sipas tri kriterëve për klasifikimin e tyre;</p> <p>3.2.5. të përcaktojë rrokjen dhe të sqarojë tingujt rrokjeformues për dallim nga ata jo rrokjeformues.</p>

2	Zhvillimi historik i gjuhës shqipe			
			<p>metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim);  metoda e demonstrimit;  metoda e krahasimit;  metoda e analizës dhe sintezës;  metoda e hulumtimit.</p>	
3.3	<p>- t'i shpjegojë shkaqet e shfaqjes së ndryshimeve tingullore (dukurive fonetike);</p> <p>- t'i përmendë disa nga ndërrimet tingullore themelore në gjuhën shqipe;</p> <p>- t'i shkruajë si duhet fjalët duke zbatuar njohuritë për ndërrimet fonetike.</p>	<p><b>Ndryshimet tingullore (dukuritë fonetike)</b></p> <p><b>Nocionet:</b>  Ndryshim pozicional (rënie e shurdhim i tingujve)  Ndryshim kombinator (metafoni, asimilim, disimilim, metatezë, shtim e rënie tingujsh)</p>	<p><b>Aktivitetet:</b>  Bëhen ushtrime për të ilustruar ndërrimet (modifikimet) e tingujve duke marrë shembuj nga ligjërimi i përditshëm dhe komunikimi i ndërsjellë me gojë e me shkrim. Shfrytëzohen edhe tekstet e krijuara prej nxënësve gjatë procesit mësimor dhe ato nëpërmjet punës nga dy nxënës kontrollohen dhe nxirren përfundimet përkatëse. Këto përfundime nxënësit i formësojnë gjatë komunikimit me gojë a me shkrim që e shfrytëzojnë më tej si mjet konkretizimi.</p> <p><b>Metodat:</b>  monolog-dialog;  puna me tekst;  metoda e demonstrimit</p>	<p>3.3.1. të bëjë emërtimin, shpjegimin dhe identifikimin e ndryshimeve fonetike duke punuar me tekst;</p> <p>3.3.2. i shkruan drejt fjalët duke iu përmbajtur rregullave për shënimin e ndryshimeve fonetike;</p> <p>3.3.3. dëgjon me vëmendje dhe i dallon ndryshimet apozicionale dhe kombinatorë të tingujve.</p>
3.4	-ta përcaktojë theksin dhe të bëjë dallimin midis theksit të fjalës dhe	<b>Theksi</b>	<p><b>Aktivitetet:</b>  Shtrohen pyetje të fokusuar para nxënësve me</p>	3.4.1. t'i sqarojë konceptet theks i fjalës dhe theks i fjalisë dhe të japë

2	Zhvillimi historik i gjuhës shqipe			
	<p>theksit të fjalisë; midis theksit dinamik, theksit të lëvizshëm e theksit të palëvizshëm në gjuhën standarde shqipe ;</p> <p>- të bëjë theksimin e fjalës / të flasë duke iu përmbajtur rregullave për theksimin e fjalëve në gjuhën shqipe (qofshin ato burimore ose fjalë të huazuara)</p> <p>- të dijë rolin e theksit për dallimin kuptimor të fjalëve me përbërje tingullore të njëjtë.</p>	<p>Veçoritë e përgjithshme dhe llojet e theksit</p> <p>Vendi i theksit në gjuhën standarde shqipe</p> <p>Rastet e përjashtimit nga rregullat themelore</p> <p>Theksimi te fjalët e huazuara</p> <p><b>Nocionet:</b>  Theksi (shenja e tij)  Theks i fjalës, theks i fjalisë  Theks dinamik, theks melodik  Theks i palëvizshëm (i qëndrueshëm, theks i lëvizshëm (i lirë)</p>	<p>qëllim që ata t'i thonë e t'i sqarojnë veçoritë e përgjithshme dhe llojet e theksit në shqipen standarde, si dhe për të nxjerrë në pah rastet kur ka përjashtime;</p> <p>Bëhen veprimtari konkretizimi me shembuj të shumtë në mënyrë që nxënësit, nëpërmjet punës individuale, në grupe dhe punës nga dy veta, t'i identifikojnë dhe t'i shqyrtojnë rregullat e vendosjes së theksit, të dallojnë dhe ta demonstrojnë theksin e fjalës dhe theksin e fjalisë, të vërejnë rolin e theksit si mjet për dallimin kuptimor të disa fjalëve.</p> <p>Veprimtari me diktim.</p> <p>Rekomandohet një konkretizim tekstor që duhet të marrë për bazë përmbajtje që kanë të bëjnë me interesat e përditshëm dhe me ngjarjet në jetën e nxënësve.</p> <p><b>Metodat:</b>  metoda audio-linguistike;  metoda e ndërveprimit;  metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë me gojë e me shkrim);  metoda e demonstrimit;  metoda e krahasimit;  metoda e punës me tekst.</p>	<p>shembuj relevantë për ta;</p> <p>3.4.2. të bëjë theksimin e drejtë të fjalëve shumërokëshe, të fjalëve të huazuara dhe t'u përmbahet rregullave për theksimin e fjalëve në shqipen standarde.</p> <p>3.4.3. të theksojë drejt fjalët e fjalitë brenda një teksti të caktuar.</p>

2	Zhvillimi historik i gjuhës shqipe			
4.	Morfologji			
4.1	<p><b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-të përcaktojë morfologjinë si degë e gramatikës dhe gramatikën si degë të gjuhësisë;</li> <li>- të shpjegojë se nga cila pikëpamje e studion fjalën morfologjia;</li> <li>-të dallojë e të sqarojë kuptimin gramatikor dhe formën gramatikore;</li> <li>-të identifikojë e të sqarojë ndërtimin e formave gramatikore;</li> <li>-të tregojë pjesët e ligjëratës dhe kriteret për klasifikimin e tyre.</li> </ul>	<p><b>Struktura morfologjike e gjuhës</b></p> <p>Morfologjia dhe sintaksa si degë të gramatikës së gjuhës shqipe</p> <p>Kuptimet gramatikore dhe format gramatikore</p> <p>Pjesët e ligjëratës</p> <p><b>Nocionet:</b> Morfologji Kuptim gramatikor, formë gramatikore; Formë sintetike, formë analitike Pjesë e ligjëratës, pjesë të ndryshueshme të ligjëratës, pjesë të pandryshueshme të ligjëratës Fjalë kuptimplotë, fjalë jokuptimplotë, fjalë thirrmore, fjalë të mëvetësishme, fjalë të pamëvetësishme</p>	<p><b>Veprimtaritë :</b></p> <p>Duke i rikujtuar nxënësit për gjuhësinë dhe degët e saj, mësimdhënësi përqendrohet te rrafshi morfologjik i sistemit gjuhësor të shqipes standarde;</p> <p>Mësimdhënësi orienton veprimtarinë përgatitore në atë mënyrë që nxënësit ta kuptojnë se fjala përveç si njësi leksikore (fjalë), mund studiohet edhe nga pikëpamja e formave dhe e kuptimeve gramatikore përkatëse (si pjesë e ligjëratës);</p> <p>Me anë të skemës së përgatitur me dy kolona me shembuj ilustrimi me tekste të shkurtra nga komunikimi i përditshëm konkretizohet ndarja e formave gramatikore në sintetike dhe analitike dhe së bashku me nxënësit interpretohen mjetet për ndërtimin e tyre;</p> <p>Veprimtaria përgatitore organizohet me tri grupe: grupi i parë ngarkohet të bëjë grupimin e pjesëve të ligjëratës sipas veçorive leksikore, grupi i dytë merr detyrë të bëjë ndarjen e fjalëve sipas veçorive morfologjike, kurse grupi i tretë të bëjëklasifikimin e pjesëve të ligjëratës sipas kriterit sintaksor.</p> <p><b>Metodat:</b></p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mundet:</b></p> <p>4.1.1. ta përkufizojë morfologjinë dhe objektin e studimit të saj;</p> <p>4.1.2. të dallojë e të sqarojë kuptimet gramatikore dhe format gramatikore;</p> <p>4.1.3. të emërtojë e të sqarojë format gramatikore sintetike dhe format gramatikore analitike;</p> <p>4.1.4. të përmendë pjesët e ligjëratës dhe të tregojë kriteret për klasifikimin e tyre;</p> <p>4.1.5. të numërojë pjesët e ndryshueshme dhe pjesët e pandryshueshme të ligjëratës dhe t'i ndajë ato në fjalë të mëvetësishme dhe në të pamëvetësishme;</p> <p>4.1.6. të dallojë fjalët kuptimplota nga ato jokuptimplota dhe fjalët e mëvetësishme nga ato të pamëvetësishme.</p>

2	Zhvillimi historik i gjuhës shqipe			
			<p>metoda e ndërveprimit;  metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim);  metoda e demonstrimit;  metoda e punës me tekst;  metoda e krahasimit;  metoda e ilustrimit</p>	
4.2	<p>-ta dallojë, ta përcaktojë dhe ta shpjegojë morfemën si njësi më e vogël e kuptimshme e gjuhës;</p> <p>-të bëjë dallimin e fjalës nga morfema;</p> <p>- të identifikojë dhe të shpjegojë morfemën rrënjore dhe morfemën ndajshesore;</p> <p>- të sqarojë rolin dhe vendin e parashtesave dhe prapashtesave dhe të formojë fjalë të prejardhura me ndajshesa dhe pa ndajshesë;</p> <p>-të tregojë formimin e fjalëve të përbëra dhe të përngjitura dhe dallimin midis tyre;</p> <p>-të përcaktojë formimin e fjalëve të</p>	<p><b>Fjala dhe pjesët e saj përbërëse</b></p> <p>Morfema dhe veçoritë e saj</p> <p>Fjala dhe morfema</p> <p>Llojet e morfemave</p> <p>Tema e fjalës dhe llojet e saj</p> <p>Mënyrat e formimit të fjalëve</p> <p><b>Nocionet:</b></p> <p>Fjalë</p> <p>Morfemë</p> <p>Morfemë rrënjore, morfemë ndajshesore</p> <p>Parashtesë, prapashtesë,</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b></p> <p>Veprimtaritë përgatitore për këtë orë synojnë të konkretizohet në mënyrë të ilustruar zberthimi i fjalëve në pjesët e saj përbërëse;</p> <p>Bëhen ushtrime gjuhësore me shembuj të përgatitur për të përcaktuar e për të shpjeguar morfemën dhe llojet e saj;</p> <p>Në mënyrë skematike njihen nxënësit me funksionin e morfemave trajtëformuese dhe atyre fjalëformuese;</p> <p>Me anë tekstesh të përgatitura e të përshtatshme nxënësit nxiten nëpërmjet punës individuale, me grupe dhe me nga dy veta që të analizojnë e të zberthejnë fjalët në pjesët e tyre përbërëse duke përcaktuar mënyrën e fjalëformimit;</p> <p>Mund të shfrytëzohet si veprimtari përgatitore edhe skema me disa kolona me morfema të ndryshme që prej tyre nxënësit të krijojnë fjalë a</p>	<p>4.2.1. të japë sqarime për morfemën si njësi më e vogël e kuptimshme e gjuhës dhe ta krahasojë atë me fonemën si njësi më e vogël gjuhësore;</p> <p>4.2.2. të bëjë dallimit dhe të sqarojë pse fjalët njëmorfemeshe nuk janë morfema;</p> <p>4.2.3. të vërejë e të ndajë morfemën rrënjore nga morfema ndajshesore e një fjalëforme dhe të shpjegojë funksionin dhe vendin e tyre;</p> <p>4.2.4. të identifikojë dhe të sqarojë rolin e morfemave fjalëformuese dhe atyre trajtëformuese;</p> <p>4.2.5. të dallojë analizën morfematike nga analiza</p>

2	<b>Zhvillimi historik i gjuhës shqipe</b>			
	<p>reja me anë të paranyjëzimit, konversionit dhe mënyrave të përziera;</p> <p>-të bëjë dallimin dhe krahasimin midis morfemës fjalëformuese dhe morfemës trajtëformuese.</p>	<p>mbaresë Nyje Prejardhje Kompozim Përngjitje Paranyjëzim Konversion</p>	<p>fjalëforma të ndryshme; Zgjidhen fjalë e shprehje të ndryshme për të ilustruar në mënyrë konkrete analizën morfematike dhe analizën fjalëformuese, duke shpjeguar se ç'është tema e fjalës dhe si ndahet ajo; Kjo pjesë e mësimdhënies së gjuhës ka synim funksional që si arritje përfundimtare t'ua mundësojë nxënësve ta kuptojnë se sikundër të gjitha dukuritë materiale dhe shpirtërore, ashtu edhe gjuha ka strukturën e vet.</p> <p><b>Metodat:</b> metoda e ndërveprimit; metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e krahasimit; metoda e ilustrimit</p>	<p>fjalëformuese dhe të sqarojë temën e fjalës dhe llojet e saj;</p> <p>4.2.6. të dallojë dhe të veçojë parashtesën, prapashtesën dhe mbaresën brenda fjalëformash të ndryshme dhe të krijojë vetë fjalëforma parashtesore, prapashtesore dhe parashtesore prapashtesore njëkohësisht;</p> <p>4.2.7. të formojë fjalë të reja me anë të kompozimit dhe përngjitjes dhe të bëjë dallimin midis tyre;</p> <p>4.2.8. të hetojë e të tregojë se a është krijuar një fjalë e re me paranyjëzim, me konversion a me mënyra të përziera.</p>
5	<b>Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi</b>			
5.1	<p><b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë:</b></p> <p>-të përkufizojë konceptet drejtshkrim dhe drejtshqiptim;</p>	<p><b>Parimet e drejtshkrimit</b></p> <p>Drejtshkrimi i gjuhës letrare shqipe dhe kodi normativ</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b></p> <p>Nxënësit orientohen te përmbajtjet e fonetikës e fonologjisë që realizohen në këtë vit shkollor; Nxënësit nxiten për të dhënë vlerësime për</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mundet:</b></p> <p>5.1.1. t'i përkufizojë konceptet drejtshkrim e drejtshqiptim dhe të arsyetojë pse drejtshkrimi dhe</p>

2	<b>Zhvillimi historik i gjuhës shqipe</b>			
	<p>-të përcaktojë drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin si pjesë të normës së shqipes standarde dhe të përcaktojë respektimin e drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit si një parakusht i rëndësishëm për kulturën e gjuhës dhe për kulturën e përgjithshme të çdo individi dhe për kulturën e mjedisit shoqëror;</p> <p>-të tregojë llojet e drejtshkrimit duke sqaruar se drejtshkrimi i shqipes standarde u mbështet kryesisht mbi parimin fonetik.</p>	<p><b>Nocionet:</b> Drejtshkrim Drejtshqiptim Parim fonetik, morfologjik dhe historik-tradicional a etimologjik Normë letrare</p>	<p>gjendjen lidhur me respektimin e këtyre rregullave në komunikimin e përditshëm me gojë e me shkrim, t'i arsyetojnë qëndrimet e veta, të tregojnë se ç'do të thotë sipas tyre të flasësh e të shkruash sipas normave standarde dhe cilat elemente të sistemit fonologjik dhe gramatikor të shqipes standarde përfshihen aty, të ofrojnë zgjidhje sa i përket ndryshimit dhe përmirësimit të gjendjes lidhur me zbatimin e shqipes standarde në ligjërimin e shkruar dhe atë gojor, të vlerësojnë shprehjen e tyre me gojë e me shkrim etj.</p> <p><b>Metodat:</b> metoda e ndërveprimit; metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit.</p>	<p>drejtshqiptimi i një gjuhe janë pjesë e normës për standardizimin e gjuhës;</p> <p>5.1.2. të thotë llojet e parimeve të drejtshkrimit dhe të sqarojë dallimet midis tyre.</p>
5.2	<p>-t'i zbatojë rregullat për drejtshkrimin e tingujve zanorë e bashkëtingëllore</p> <p>-të vërejë në tekstin e shkruar përdorimin normativ dhe jonormativ të zanoreve, të diftongjeve dhe të</p>	<p><b>Drejtshkrimi i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve</b></p> <p>Përdorimi i drejtë i zanoreve <b>e</b> dhe <b>ë; u</b> dhe <b>y</b>; drejtshkrimi i diftongjeve <b>ua, ue, ie, ye</b> dhe i togjeve zanore</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b> Veprimtaritë mësimore gjatë orëve fokusohen në paraqitjen e situatave të përdorimit jonormativ të zanoreve e të bashkëtingëlloreve, në shpjegimin e shkeljeve drejtshkrimore dhe në zbatimin e rregullave për përdorimin normativ të zanoreve, bashkëtingëlloreve, diftongjeve,</p>	<p>5.2.1. t'i shkruajë si duhet zanoret dhe bashkëtingëlloret varësisht nga rrethimet me tingujt e tjerë;</p> <p>5.2.2. ta vërejë dhe ta përmirësojë në një tekst të shkruar përdorimin e gabuar të disa zanoreve e bashkëtingëlloreve karakteristike,</p>

2	Zhvillimi historik i gjuhës shqipe			
	<p>togjeve të zanoreve;</p> <p>- të hetojë në ligjërimin e folur dhe atë të shkruar përdorimin e drejtë ose jo të togjeve bashkëtingëllore në të gjitha pozicionet në fjalë.</p>	<p>Shqiptimi normativ dhe shkeljet në përdorimin e togjeve bashkëtingëllore <i>mb, nd, ng, ngj</i> në pozicione të ndryshme.</p>	<p>togjeve zanore e togjeve bashkëtingëllore varësisht nga konteksti tingullor ku përdoren. Shembujt për ilustrim duhet marrë prej tekstesh të shkruara në stile të ndryshme funksionale; shfrytëzohen edhe tekste të shkruara prej nxënësve, të cilat merren prej hartimeve ose detyrave të tjera me shkrim të tyre. Ushtrimet e tipit lexim me zë dhe lexim shprehës të teksteve në stile të ndryshme, përshkrimi, diktimi e vetëdiktimi, hetimi dhe përmirësim i gabimeve drejtshkrimore dhe ushtrime të tjera me qëllim të përmirësimit të gjuhës së shkruar të të rinjve duhet të jenë formë e përhershme e punës gjatë orëve. Gjatë orës mësimore nxënësit nxiten për t'i shfrytëzuar <i>Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe</i> dhe <i>Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe</i>.</p> <p><b>Metodat:</b>  metoda e ndërveprimit;  metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim);  metoda e demonstrimit;  metoda e krahasimit;  metoda e korigjimit.</p>	<p>të disa diftongjeve e të togjeve zanore e togjeve bashkëtingëllore;</p> <p>5.2.3. t'i zbatojë rregullat për drejtshkrimin e tingujve zanorë e bashkëtingëllore në pozicione të ndryshme.</p>



2	Zhvillimi historik i gjuhës shqipe			
5.3	<p>- t'i tregojë rregullat për përdorimin e shkronjës së madhe;</p> <p>- ta vërejë në tekstin e shkruar shkrimin jonormativ të shkronjës së madhe dhe të vogël në fillim të fjalës dhe t'i korrigjojë shkeljet drejtshkrimore;</p> <p>-të shkruajë shkronjën e madhe a të vogël në fillim të fjalës në pajtim me rregullat e drejtshkrimit të shqipes standarde.</p>	<p><b>Përdorimi i shkronjës së madhe</b></p> <p>Shkronja e madhe në fillim të fjalisë;</p> <p>Shkrimi me shkronjën e parë të madhe i emrave të përveçëm kudo që ata përdoren në fjali;</p> <p>Shkrimi i emrave të institucioneve, funksioneve të larta, organizatave, shkurtimeve, festave, titujve të librave etj.;</p> <p>Përdorimi i shkronjës së parë të vogël.</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b></p> <p>Përmbajtjet mësimore lidhur me shkrimin e fjalëve me shkronjën e parë të madhe a të vogël janë në pajtim me rregullat dhe zgjidhjet që jepen në <i>Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe</i>, përkatësisht në <i>Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe</i>. Së këtejmi del e domosdoshme të konsultohen këto burime drejtshkrimi, por edhe të tjera të ngjashme. Këto tekste mund të merren në formën e botuar, por edhe në formë elektronike.</p> <p>Përmbajtjet me karakter ilustrues të veprimtarive mësimore paraqesin zgjedhje të situatave më karakteristike të përdorimit të shkronjës së parë të madhe e që kanë të bëjnë me nevojat e komunikimit të përditshëm me shkrim të nxënësve si dhe me modelet e supozuara të komunikimit me shkrim që lidhen me profesionin arsimor përkatës.</p> <p>Si formë kryesore e punës mësimore përdoren ushtrimet me shkrim nëpërmjet të cilave nxënësit, kuptohet me ndihmën e mësimitdhënësit, i regjistrojnë, i shpjegojnë dhe i përmirësojnë shmangiet drejtshkrimore që kanë të bëjnë me shkrimin e shkronjës së parë të madhe ose të vogël.</p>	<p>5.3.1. t'i zbatojë rregullat e përdorimit të shkronjës së madhe;</p> <p>5.3.2. ta vërejë në tekstin e shkruar përdorimin e gabuar të shkronjës së madhe në fillim të fjalisë a të rreshtit të ri; tek emrat e përveçëm dhe tek emërtimet e institucioneve, organizatave, emrave gjeografikë etj;</p> <p>5.3.3. të identifikojë gabimet gjatë përdorimit të shkronjës së parë të vogël, si dhe kur ajo nuk shkruhet në pajtim me rregullat e drejtshkrimit të shqipes standarde.</p>

2	Zhvillimi historik i gjuhës shqipe			
			<p><b>Metodat:</b>  metoda e ndërveprimit;  metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim);  metoda e demonstrimit;  metoda e krahasimit;  metoda e korrigjimit;  metoda e hulumtimit.</p>	
5.4	<p>- t'i zbatojë rregullat për shkrimin e fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë lidhëse në mes</p>	<p><b>Shkrimi njësh, ndaras dhe me vizë në mes</b></p> <p><b>Nocionet:</b>  Fjalë të përbëra  Fjalë të përngjitura  Lokucion (shprehje gramatikore)  Emërtime të përbëra</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b>  Mësimdhënësi përgatit shembuj për të paraqitur e për të shpjeguar rregullat e shkrimit të fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë lidhëse në mes.  Përgatit tekste për ushtrime gjuhësore ku nxënësit do të bëjnë korrigjimet e gabimeve sa i përket shkrimit të fjalëve.  Bëhet diktim (i një teksti me emërtime e terma nga fusha e profesionit të ardhshëm të tyre) për të përcaktuar shkallën e zotërimit të rregullave drejtshkrimore për shkrimin e fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes.</p> <p><b>Metodat:</b>  monolog-dialog;  puna me tekst;  metoda e demonstrimit</p>	<p>5.4.1. t'i zbatojë rregullat për shkrimin e fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë lidhëse në mes;</p> <p>5.4.2. t'i gjejë e t'i korrigjojë gabimet sa u përket rregullave për shkrimin e fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë lidhëse në mes.</p>

2	<b>Zhvillimi historik i gjuhës shqipe</b>			
5.5	<p>-t'i zbatojë drejt shenjat e pikësimit;</p> <p>-të bëjë bartjen (ndarjen) e pjesës së fjalës nga një rresht në tjetrin.</p>	<p><b>Shenjat e pikësimit</b></p> <p>Përdorimi i shenjave kryesore të pikësimit</p> <p>Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit</p> <p><b>Nocionet:</b>  Pikë  Presje  Pikë presje  Dy pika  Tri pika  Pikëpyetje  Pikëçuditje  Vizë  Vizë lidhëse  Thonjëza  Apostrof  Kllapa  Yllth</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b></p> <p>Përgatiten e shpërfaqen shembuj ilustrimi për të paraqitur dhe shpjeguar përdorimin e shenjave përkatëse të pikësimit. Për këtë qëllim shfrytëzohen tekste të larmishme.</p> <p>Përgatiten ushtrime gjuhësore në mënyrë që nxënësit të bëjnë ndreqjet e gabimeve sa i përket përdorimit të shenjave të pikësimit. Zhvillohet diktim me qëllim kontrollimi të shkallës së zotërimit të rregullave për përdorimin e drejtë të shenjave të pikësimit e të shenjave të tjera shkrimore.</p> <p><b>Metodat:</b>  monolog-dialog;  puna me tekst;  metoda e demonstrimit</p>	<p>5.5.1 t'i përdorë drejt shenjat e pikësimit;</p> <p>5.5.2. t'i gjejë e t'i përmirësojë gabimet e bëra me qëllim sa i përket përdorimit të shenjave të pikësimit.</p>
5.6	<p>-t'i përdorë ashtu si duhet rregullat për shkurtimin e fjalëve dhe për t'i shkruar me shkurtesë emrat shumëfjalësh, të titujve dhe emërtimeve të ndryshme.</p>	<p><b>Shkurtesat dhe shkurtimi i fjalëve</b></p> <p><b>Nocionet:</b>  shkurtim;  shkurtesë (akronim)</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b></p> <p>Mësimdhënësi përgatit shembuj ilustrimi për të treguar e për të sqaruar rregullat për shkurtimin e fjalëve dhe për t'i shkruar me shkurtesë emrat shumëfjalësh, titujt dhe emërtimet;</p>	<p>5.6.1 t'i zbatojë rregullat për shkurtimin e fjalëve dhe për t'i shkruar me shkurtesë emrat shumëfjalësh;</p> <p>5.6.2. t'i identifikojë emrat, titujt</p>

2	Zhvillimi historik i gjuhës shqipe			
			<p>Me anë pyetjesh të fokusuara shtyhen nxënësit të japin vetë shembuj;  Nëpërmjet prezantimit shpjegohen mënyrat për leximin e drejtë të shkurtesave;  Bëhen ushtrime me fjalë e shprehje të marra nga komunikimi i përditshëm.</p> <p><b>Metodat:</b>  monolog-dialog;  puna me tekst;  metoda e demonstrimit</p>	dhe emërtimet e dhëna me anë shkurtesash (shembujt nga komunikimi i përditshëm dhe nga profesioni i ardhshëm).
6	Sintaksë			
6.1	<b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë:</b> - ta përkufizojë sintaksën si degë e gramatikës; - t'i përcaktojë njësitë sintaksore dhe veçoritë kryesore të tyre.	<b>Sintaksa</b> Njësitë kumtuese dhe njësitë ndërtuese  <b>Nocionet:</b> Sintaksë Njësi sintaksore Fjali Periudhë	<b>Veprimtaritë:</b> Nxënësit njihen në përgjithësi me sintaksën, objektin studimor të saj dhe me njësitë sintaksore. Mësimdhënësi jep shpjegime për veçoritë e njësive sintaksore. Përgatit ushtrime për nxënësit që të kuptojnë dallimet midis njësive sintaksore kumtuese dhe njësive sintaksore ndërtuese. Gjatë veprimtarisë mësimore në klasë nxiten nxënësit të thonë njësi kumtuese lidhur me situata të ndryshme ligjërimore dhe t'i shohin dallimet midis njësive kumtuese dhe	<b>Nxënësi/nxënësja mundet:</b> 6.1.1. të bëjë dallimin midis njësive sintaksore kumtuese dhe njësive sintaksore ndërtuese; 6.1.2. të identifikojë fjalinë dhe periudhën si njësi kumtuese themelore.

2	Zhvillimi historik i gjuhës shqipe			
			<p>jokumtuese.</p> <p><b>Metodat:</b> monolog – dialog; metoda e demonstrimit; metoda e ilustrimit.</p>	
6.2	<p>-të përcaktojë togfjalëshin si njësi sintaksore më e madhe se fjala dhe më e vogël se fjalia;</p> <p>-përmendë e të sqarojë veçoritë kryesore të togfjalëshit dhe ndarjet e tij;</p> <p>-të përcaktojë gjymtyrën e fjalisë si njësi ndërtuese e njësive kumtuese;</p> <p>-të bëjë dallimin midis togfjalëshit dhe gjymtyrës së fjalisë;</p> <p>- të dallojë marrëdhëniet (raportet) sintaksore dhe të sqarojë mjetet kryesore për shprehjen e tyre.</p>	<p><b>Struktura gramatikore e njësive kumtuese</b> Njësitë ndërtuese të fjalisë Veçoritë kryesore të togfjalëshit dhe llojet e tij Gjymtyrët e fjalisë dhe ndarja e tyre Marrëdhëniet sintaksore dhe mjetet për shprehjen e tyre</p> <p><b>Nacionet:</b> Togfjalësh; Gjymtyrë fjalie Marrëdhënie barazie dhe varësie Mjete morfologjike, mjete sintaksore, mjete fonetike</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b> Për t'i përgatitur veprimtaritë për këtë pjesë shfrytëzohen tekste të afërta për nxënësit dhe që kanë të bëjnë me komunikimin e tyre të përditshëm. Duke u bërë pyetje të fokusuara bëhet ndërlidhja me njohuritë e tyre gramatikore nga shkollimi fillor. Bëhen ushtrime për të kuptuar togfjalëshin si njësi ndërtues dhe për të dalluar llojet e ndarjet e tij. Me anë të shembujve ilustrues në kuadër të veprimtarisë përgatitore u shpjegohet dallimi midis togfjalëshit dhe gjymtyrës së fjalisë. Përgatiten disa fjali stilesh të ndryshme funksionale dhe në mënyrë skematike analizohen me nxënësit pjesët përbërëse të tyre që përfaqësojnë gjymtyrë fjalie. Me anë të kësaj strukture përgatitore mësimdhënësi me shembuj përkatës ilustrimi shpjegon edhe marrëdhëniet sintaksore dhe</p>	<p>6.2.1. të dallojë togfjalëshat si pjesë përbërëse të njësive kumtuese;</p> <p>6.2.2. t'i emërtojë e t'i identifikojë llojet e ndryshme të togfjalëshave;</p> <p>6.2.3. të identifikojë gjymtyrët e fjalisë dhe të sqarojë cilat lloje fjalësh mund ta kryejnë funksionin e tillë;</p> <p>6.2.4. t'i thotë e t'i veçojë gjymtyrët kryesore nga ato jokryesore të fjalisë;</p> <p>6.2.5. t'i dallojë marrëdhëniet sintaksore të barazisë dhe ato të varësisë dhe t'i tregojë mjetet për shprehjen e tyre.</p>

2	Zhvillimi historik i gjuhës shqipe			
			<p>mjetet për shprehjen e tyre.</p> <p><b>Metodat:</b> monolog – dialog; metoda e demonstrimit; metoda e ilustrimit</p>	
7	Komunikimi dhe shkrimet funksionale			
7.1	<p><b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë:</b></p> <p>-vetë të shkruajë ese;</p> <p>-t`i dallojë format e teksteve funksionale dhe t`i aplikojë rregullat e shkrimit të teksteve të tilla;</p> <p>-të demonstrojë rregulla të shkrimeve funksionale.</p>	<p>Eseja (struktura dhe kompozicioni);</p> <p>Procesverbali dhe raporti;</p> <p>Lajmërimi dhe oferta;</p> <p>Lutja, ankesa, kërkesa;</p> <p>Letra (zyrtare, private, elektronike).</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b></p> <p>Mësimdhënësi kërkon nga çdo nxënës të punojë një ese, sipas rregullave të dhëna për formën dhe përmbajtjen e esesë.</p> <p>Nxënësit ndahen në grupe dhe secilit grup i jepet për detyrë të shkruaj një lloj të caktuar të tekstit funksional.</p> <p>Nga secili grup kërkohet që të lexohen tekstet e shkruara, të cilat komentohen.</p> <p><b>Metodat:</b> metoda e monologut dhe dialogut; metoda e demonstrimit; metoda e tekstit (tekst-metoda); metoda e interpretimit.</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mundet:</b></p> <p>7.1.1. t`i përkufizojë rregullat e hartimit të esesë dhe të shkrimeve funksionale;</p> <p>7.1.2. të punojë ese dhe tekste funksionale;</p> <p>7.1.3. t`i respektojë rregullat e drejtshkrimit gjatë hartimit të teksteve të ndryshme.</p>

## Njësia modulare: LETËRSI

Nr. rendor	Rezultatet nga të nxënit	Përmbajtjet dhe nocionet	Veprimtaritë dhe metodat	Kriteret për vlerësim*
1	<b>Teoria e letërsisë</b>			
1.1	<p><b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë:</b></p> <p>-ta shpjegojë lidhjen e letërsisë me artet tjera dhe të identifikojë specificitetet e saj;</p> <p>- të njihet me fillimin e letërsisë së shkruar.</p>	<p><b>Sinkretizmi</b> Llojet e arteve – Letërsia si art</p> <p><b>Nocionet:</b> Sinkretizëm Art Letërsi</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b> Jepen shembuj të sinkretizmit, hapet diskutim dhe bëhet paraqitje auditive dhe vizuale e llojeve të ndryshme të arteve (baletit, operës etj.), me qëllim që nxënësit vetë të vijnë në përfundime të caktuara; Nxënësit nxiten të diskutojnë rreth letërsisë si art dhe rreth specificiteteve të saj.</p> <p><b>Metodat:</b> metoda e demonstrimit; metoda e dialogut; metoda e punës në grupe.</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mundet:</b></p> <p>1.1.1. ta shpjegojë nocionin sinkretizëm; t'i ndajë dhe klasifikojë të gjitha artet që dalin nga sinkretizmi;</p> <p>1.1.2. t'i emëtojë veçoritë, me të cilat letërsia klasifikohet si art më vete.</p>

\* Janë përfshirë standardet/indikatorët për arritjen e rezultateve nga të nxënit sipas të cilëve përcaktohen kriteret e vlerësimit.

1.2	<p>-ta identifikojë mitin dhe ta njohë rolin e mitit në krijimin e letërsisë;</p> <p>-t`i emërtojë, ilustrojë dhe krahasojë specificitetet e mitit;</p> <p>-t`i interpretojë dhe argumentojë toposet në mite.</p>	<p><b>Miti dhe mitologjia</b></p> <p>Mitet e huaja: miti i Orfeut, Odiseut, Edipit etj.</p> <p>Mitet shqiptare ( miti i sakrifikimit, fjalës së dhënë etj), figurat mitologjike.</p> <p>Lidhja e mitologjisë më librat e shenjtë (Biblën dhe Kuranin, si burime të rëndësishme, në të cilat mbështetet letërsia).</p> <p><b>Nacionet:</b> Mit Mite antike Mite shqiptare Libra të shenjtë</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b></p> <p>Jepen shpjegime mbi mitin, i cili definohet <i>si rrëfim i shenjtë</i> dhe si hipotekst i rëndësishëm letrar.</p> <p>Nëpërmjet të punës në grupe motivohet analiza dhe interpretimi i miteve të ndryshme (si mitit të zanafillës, miteve fetare, mitit të sakrifikimit, etj).</p> <p>Diskutohen dhe shpjegohen veçoritë e mitit dhe të njëjtat shpjegohen nëpërmjet të fragmenteve të zgjedhura.</p> <p>Me leximin e fragmenteve dhe diskutimin rreth tyre, shpjegohet lidhja e elementeve motivoro-tematike në mite.</p> <p>Lexohen, analizohen dhe interpretohen segmente nga librat e shenjtë dhe diskutohet rreth tyre.</p> <p><b>Metodat:</b> metoda interpretativo-analitike; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e krahasimit; metoda e tekstit (tekst-metoda).</p>	<p><b>Nxënësi mund:</b></p> <p>1.2.1 .ta shpjegojë lidhjen mes mitit dhe letërsisë;</p> <p>1.2.2. të analizojë dhe krahasojë mite sipas temës;</p> <p>1.2.3. t`i krahasojë toposet në mite të ndryshme.</p>
1.3	<p>-ta dallojë letërsinë si shkencë;</p>	<p><b>Historia e letërsisë;</b> <b>Teoria e letërsisë;</b></p>	<p><b>Veprimtaritë:</b> lexohen fragmente nga studime të</p>	<p>1.3.1. të dallojë letërsinë si shkencë;</p>



	- të dallojë degët e letërsisë dhe fushat e studimit të tyre.	<b>Kritika letrare.</b> <b>Nocionet:</b> Teori e letërsisë Histori e letërsisë Kritikë letrare	ndryshme teorike, nga tekste kritike dhe tekste që kanë të bëjnë me periodizimin dhe historinë e letërsisë shqipe, me qëllim që nxënësit të mund të dallojnë fragmentet e një lloji të tekstit nga lloji tjetër. <b>Metodat:</b> metoda e monologut dhe dialogut; metoda e krahasimit; metoda e tekstit (tekst-metoda).	1.3.2 të dallojë degët e letërsisë; 1.3.3 të dallojë dhe identifikojë fragmente të ndryshme të teksteve nga fusha e letërsisë si shkencë (një tekst historiko -letrar nga një tekst kritik ose teorik).
1.4	-të memorojë nocione dhe kritere për ndarjen e letërsisë; -ta njihë klasifikimin e krijimeve letrare; -të shpjegojë dhe numërojë veçoritë e klasifikimeve të ndryshme.	<b>Ndarja/ Tipologjia e letërsisë</b> <b>Gjinitë dhe llojet letrare</b> <b>Letërsia gojore dhe letërsia artistike</b> <b>Nocionet:</b> Ndarja sipas autorësisë Gjinitë letrare Lirika Epika Dramatika	<b>Veprimtaritë:</b> Nëpërmjet të leximit dhe konkretizimit shpjegohen nocionet gjini letrare dhe lloj letrar. Jepen informacione për klasifikimin e letërsisë në gjini dhe lloje letrare dhe nëpërmjet të shembujve, kërkohet nga nxënësit që t`i verifikojnë nocionet e mësuara. Nëpërmjet të punës në grupe të vogla , tekste të caktuara krahasohen dhe shpjegohet se cilës gjini apo lloji letrar i takojnë. Nxënësit motivohen që t`i shprehin mendimet e veta rreth klasifikimit të teksteve dhe të njëjtat t`i shpjegojnë. <b>Metodat:</b>	1.4.1. të numërojë ndarjen e letërsisë; 1.4.2. të dallojë tekste sipas autorësisë dhe sipas gjinisë letrare; 1.4.3 të identifikojë dhe krahasojë lloje të ndryshme tekstesh nga secila gjini; 1.4.4 të demonstrtojë dhe përgatisë shembuj për çdo lloj ndarje të letërsisë.

			metoda e demonstrimit; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e tekstit (tekst metoda).	
1.5	<p>- të emërtojë dhe përshkruajë nocione që kanë të bëjnë me lirikën;</p> <p>- t`i njohë dhe krahasojë krijimet letrare, që i takojnë kësaj gjinie letrare;</p> <p>- të konsolidojë motivin e këngës lirike;</p> <p>- t`i shënojë figurat stilistikore dhe të analizojë krijime lirike, duke i identifikuar mjetet stilistikore dhe duke i kategorizuar të njëjtat.</p>	<p><b>Lirika</b></p> <p><b>Nocionet:</b> Ritmi Rima Ttheksi Vargu Strofa Kompozicioni (poezi astrofike, heterostrofike dhe strofike) Subjekti lirik Klasifikimi i motiveve Figurat stilistike (epiteti, krahasimi, metafora, metonimia, personifikimi, hiperbola, litota, epifora, anafora, gradacioni, antiteza, pyetja retorike, alegoria, aliteracioni, asonanca etj).</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b> Nëpërmjet të formave të ndryshme të konkretizimit dhe shembujve shpjegohet klasifikimi i lirikës dhe veçoritë e saj. Nëpërmjet të punës individuale dhe asaj grupore, kërkohet që nxënësit njohuritë e fituara t`i përforcojnë nëpërmjet të poezive konkrete lirike të përcaktojnë llojin e vargut, ritmin, rimën, strofën, kompozicionin e poezisë. Hulumtohen dhe kërkohen shembuj të poezive të ndryshme përnjës strukturë dhe shpjegohet mënyra e selektimit dhe klasifikimit në lloje të caktuara. Identifikohen veçoritë e lirikës në shembujt e dhënë dhe të njëjtat kategorizohen. Analizohen shembuj të lirikës, nëpërmjet të cilave identifikohen figurat stilistike. Parashtrihen pyetje në lidhje me vargje të zgjedhura dhe kërkohet të</p>	<p>1.5.1 të dallojë subjektin lirik dhe të identifikojë lloje të caktuara të rimës, ritmit, vargut dhe strofës; 1.5.2 të shpjegojë dhe analizojë kompozicionin e poezisë; 1.5.3 të dallojë poezitë lirike me motive të ndryshme dhe t`i krahasojë me gjinitë tjera; 1.5.4 të praktikojë përdorimin e figurave stilistikore (shembuj të gjuhës së figurshme) në kontekste të ndryshme gjuhësore.</p>

			shkruhen shembuj analog.  <b>Metodat:</b> metoda demonstrative; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e tekstit (tekst metoda); metoda e krahasimit; metoda interaktive.	
1.6	<p>-të emërtojë nocione që kanë të bëjnë me epikën, t`i përshkruajë veçoritë e saj;</p> <p>- të dallojë dhe të krahasojë vepra që i takojnë kësaj gjinie;</p> <p>-t`i tregojë elementet e krijimit epik dhe të analizojë një krijim epik;</p> <p>-të klasifikojë krijime epike sipas formës;</p> <p>-të tregojë veçoritë e epit dhe të krijimeve epike prozaike dhe t`i dallojë veçoritë epike në krijime konkrete epike;</p> <p>-t`i krahasojë krijimet epiko-lirike dhe t`i tregojë veçoritë epike dhe</p>	<p><b>Epika</b></p> <p><b>Nocionet:</b> Tema Narracioni Narratori Fabula Personazhi Kronotopi (koha, hapësira)</p> <p><b>Llojet epike në vargje dhe në prozë</b></p> <p><b>Nocionet:</b> Epi Poezia epike Tregimi Skica Novela Romani</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b> Shpjegohet klasifikimi i epikës, veçoritë dhe llojet e saj. Nëpërmjet të punës individuale ose grupore nga nxënësit kërkohet t`i gjejnë/ identifikojnë tiparet e epikës, t`i krahasojnë veçoritë dhe të diskutojnë për format dhe për kompozicionin e krijimeve epike. Nëpërmjet të shembujve përkatës nga poezia epike, tregimi, skica, novela e romani, zbulohen elementet e krijimit epik, nëpërmjet të pyetjeve orientuese. Përshkruhen karakteristikat, nëpërmjet të elementeve të zbuluara dhe përdoren në kontekste të ndryshme gjuhësore, nëpërmjet të shembujve nga çfarëdo lloji të tekstit prozaik.</p>	<p>1.6.1 të njohë dhe dallojë tipatet e epikës në raport me gjinitë tjera;</p> <p>1.6.2 të gjejë narratorin, narracionin, kohën dhe hapësirën e veprimit , fabulën dhe personazhet e veprës epike;</p> <p>1.6.3 të dallojë format epike në vargje dhe ato në prozë dhe t`i katagorizojë karakteristikat e ndryshme epike;</p> <p>1.6.4 të paraqesë tiparet e veprave epiko-lirike, duke i rekonstruuar elementet epike dhe ato lirike.</p>

	lirike në shembujt e dhënë.	<b>Llojet epiko-lirike</b>  <b>Nocionet:</b> Elemente lirike dhe epike Romansa Balada Poema	Analizohen krijime epiko - lirike në grupe të vogla dhe nxitet diskutimi rreth elementeve epike dhe lirike në tekstet e dhëna. Vrojtohen veçoritë e llojeve epiko-lirike dhe përforcohen njohuritë, nëpërmjet të shembujve përkatës.  <b>Metodat:</b> metoda demonstruese; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e tekstit (tekst- metoda); metoda interaktive.	
1.7	-të emërtojë nocione që kanë të bëjnë me dramatikën, t`i numërojë veçoritë e saj;  -të njohë dhe krahasojë lloje të veprave dramatike;  -të shënojë elementet dramatike, të analizojë vepra dramatike dhe të gjykojë mbi ta.	<b>Dramatika</b>  <b>Nocionet:</b> Skena Akti Koha Hapësira Konflikti Etapa të veprimit  <b>Llojet dramatike</b>  <b>Nocionet:</b> Tragjedia Komedia Drama	<b>Veprimtaritë:</b> Shpjegohet klasifikimi i dramatikës dhe veçoritë e saj. Analizohen elementet e teksteve dramatike, të sugjeruara nga mësim-dhënësi. Nëpërmjet të punës në grupe ose punës individuale, kërkohet të verifikohen njohuritë e fituara në vepra përkatëse dramatike.  <b>Metodat:</b> metoda e demonstrimit;	1.7.1 të identifikojë dhe të dallojë veçoritë e dramatikës përkundër gjinive tjera;  1.7.2 t`i zbulojë etapat e veprimit, personazhet, kohën dhe hapësirën e ngjarjes dramatike;  1.7.3 të klasifikojë lloje dramatike;  1.7.4. të analizojë dhe vijë në përfundime të caktuara për vepra të caktuara dramatike (për veprimin, përmbajtjen, për personazhet, për rëndësinë e tyre).

		<p><b>Sqarim:</b> Gjatë përpunimit të çdo pjesë të kësaj tërësie, shfrytëzohet literaturë përkatëse, me shembujt e së cilës nxënësit, në mënyrë konkrete, do ta përvetësojnë çdo nocion.</p>	<p>metoda e monologut dhe dialogut; metoda e tekstit (tekst- metoda); metoda e krahasimit.</p>	
2	<b>Letërsia gojore (popullore)</b>			
2.1	<p><b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë:</b></p> <p>-ta njohë dhe vlerësojë letërsinë gojore, si paramodel i letërsisë së shkruar shqipe;</p> <p>-të njohë karakteristikat e letërsisë popullore;</p> <p>-të njohë historinë e folkloristikës shqiptare;</p> <p>-të njohë dhe dallojë gjinitë dhe llojet e ndryshme të letërsisë gojore (lirikën, epikën historike dhe prozën);</p> <p>- të dallojnë lirikën familjare e shoqërore dhe veçoritë artistike</p>	<p><b>Letërsia gojore – llojet e saj</b></p> <p><b>Nocionet:</b> Këngët e motmotit Këngët dhe ritet familjare Proverbat Gjëzat Përrallat Legjendat Anekdotat Këngët legjendare Baladat Këngët kreshnike Këngët historike Këngët shoqërore lirike Këngët e nizamëve Këngët e kaçakëve Këngët e mërgimit Këngët e dashurisë</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b> Fillimisht shpjegohet nocioni folklor dhe letërsi gojore dhe çështja e autorësisë në këtë letërsi. Nëpërmjet të shembujve shpjegohet roli i letërsisë gojore dhe raporti i saj me letërsinë artistike, të cilës i shërben si paratekst. Shpjegohen karakteristikat e letërsisë gojore dhe llojet e saj. Nxënësit nxiten të diskutojnë për llojet e folklorit që i kanë të njohura dhe ta japin ndonjë shembull. Nëpërmjet të punës në grupe kërkohet që nxënësit, duke punuar në tekste konkrete, të shprehin mendimet e tyre për llojin, të cilit i takon shembulli i dhënë, për kompozicionin, motivin, temën, figurat stilistike, heronjtë.</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mundet:</b></p> <p>2.1.1. të njohë dhe dallojë llojet e ndryshme të letërsisë gojore;</p> <p>2.1.2. ta shpjegojë raportin e letërsisë gojore me atë të shkruar;</p> <p>2.1.3. të dallojë lirikën familjare nga ajo shoqërore;</p> <p>2.1.4. të analizojë një vepër të caktuar të letërsisë gojore;</p> <p>2.1.5. të shkruaj një ese për një vepër të caktuar nga letërsia gojore, ku do të shpreh mendimet e veta të argumentuara.</p>

	të tyre.		Nxënësit motivohen që të shkruajnë ese për një lloj të letërsisë gojore, sipas zgjedhjes së tyre.  <b>Metodat:</b> metoda e demonstrimit; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e krahasimit; metoda e tekstit (tekst - metoda).	
<b>3</b>	<b>Historia e letërsisë</b>			
3.1	<b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë:</b>  -ta përshkruajë rrugën zhvillimore të letërsisë.	<b>Zhvillimi historik i letërsisë</b>  Pasqyrë e përgjithshme diakronike e zhvillimit historik të letërsisë (përiudhat letrare dhe drejtimit letrare).  Pasqyrë e letërsive më të vjetra në botë (letërsisë asiro-babilonase, letërsisë së vjetër indase, letërsisë së vjetër hebreje, letërsisë antike greke e romake).	<b>Veprimtaritë:</b> Hapet diskutim dhe jepet shpjegim rreth rrugës zhvillimore të letërsisë , duke filluar nga letërsitë më të vjetra. Diskutohet për letërsitë më të vjetra botërore dhe veprat më të vjetra të njohura.  <b>Metodat:</b> metoda demonstrative; metoda interaktive.	<b>Nxënësi/nxënësja mundet:</b>  3.1.1. ta njohë boshtin kohor të paraqitjes së drejtimeve të caktuara letrare; 3.1.2. t`i emërtojë dhe numërojë letërsitë më të vjetra botërore; 3.1.3. ta shpjegojë rëndësinë e letërsive më të vjetra botërore.
3.2	-t`i dallojë elementet epike në veprën "Epi i Gilgameshit";  -ta analizojë përmbajtjen e epit;	<b>"Epi i Gilgameshit"</b>  <b>Nocionet:</b> Tema	<b>Veprimtaritë:</b> Nëpërmjet të pyetjeve të para-shtruar dhe punës në grupe nxitet analiza e veprës dhe diskutimi rreth	3.2.1. të dallojë dhe përcaktojë temën, kompozicionin, narratorin, narracionin, personazhet dhe fabulën;

	-t`i analizojë personazhet e Gilgameshit dhe Enkidu-së.	Kompozicioni Struktura Narracioni Narratori Personazhet Fabula	saj. Nxënësit orientohen të përcaktojnë, përshkruajnë dhe të gjykojnë për personazhet e veprës. Motivohet diskutimi për kërkesat universale njerëzore dhe për frikën. Nëpërmjet të leximit të kujdesshëm të fragmenteve të zgjedhura, nxënësit orientohen të zgjedhin një pjesë të preferuar të epit dhe të njëjtën e shpjegojnë.  <b>Metodat:</b> metoda interpretativo-analitike; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e tekstit (tekst- metoda) metoda e krahasimit; metoda interaktive.	3.2.2. ta analizojë dhe interpretojë përmbajtjen e epit;  3.2.3. t`i analizojë dhe krahasojë personazhet;  3.2.4. të shkruajë ushtrim me shkrim (ese), ku do t`i shpreh qëndrimet e veta me fakte dhe argumente, me mendime të arsyetura
3.3	-t`i njohë dhe paraqësë specificitetet e epit të Homerit (kompozicionin, përshkrimin e fushbetejave, përdorimin e figurave stilistikore);  -ta analizojë përmbajtjen e “Iliadës” (kënga I,VI, XVIII и XXII), nëpërmjet të identifikimit të attributeve të Akilit dhe Hektorit dhe krahasimit	<b>Homeri – bio-bibliografia dhe intertretimi i “Iliadës”</b>  <b>Nocionet:</b> Homeri Iliada Miti Digresionet Epizodet e inkorporuara Përsëritjet Heksametri	<b>Veprimtaritë:</b> Shpjegohen të dhënat bio-bibliografike për Homerin dhe diskutohet për autotësinë dhe çështjen homerike. Diskutohet rreth kohës së hartimit të “Iliadës”. Duke shfrytëzuar njohuritë paraprake mbi mitin, nëpërmjet të metodës interaktive, shpjegohet lidhja e epit me mitin. Nëpërmjet të prezantimit vizual me	3.3.1. t`i dallojë dhe konsolidojë veçoritë epike në “Iliadën” (digresionet, përshkrimet, përdorimin e figurave stilistikore në këngën I,VI, VIII dhe XXII).  3.3.2. ta dallojë dhe përcaktojë temën, kompozicionin, narracionin, narratorin, personazhet, fabulën dhe ta interpretojë përmbajtjen e epit.

	të tyre.	<p>Përshkrime të detajuara</p> <p><b>Elementet epike në "Iliadën" dhe "Epin e Gilgameshit"</b></p> <p><b>Nocione:</b> Epi Prania e zotërave Motivet Krahasimi Epiteti</p>	<p>skena nga filmi "Troja", vazhdon diskutimi rreth luftës së Trojës. Njëpërmjet të pyetjeve të parashtruara zbulohen motivet e epitdashuria, miqësia, herozimi. Njëpërmjet të punës në grupe përshkruhet dhe krahasohet personazhi i Akilit (Arqileut) dhe Hektorit;</p> <p>Dallohen karakteristikat epike të veprës dhe stili i veprës.</p> <p>Jepen udhëzime të qarta për hartimin e një eseu që, në qendër të vëmendjes ka përmbajtjen e epit.</p> <p><b>Metodat:</b> metoda interpretativo-analitike; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e tekstit (tekst metoda); metoda e krahasimit.</p>	<p>3.3.3. t'i krahasojë dhe t'i vlerësojë veprimet e personazheve, njëpërmjet të fragmenteve të zgjedhura dhe t'i shpreh qëndrimet e veta.</p> <p>3.3.4. t'i krahasojë, analizojë dhe sintetizojë elementet e përbashkëta (veçoritë e përbashkëta) të "Iliadës" dhe "Epin të Gilgameshit".</p> <p>3.3.5. të shkruaj një esë, ku do t'i shpreh mendime e veta të argumentuara rreth "Iliadës".</p>
3.4	<p>-t'i njohë dhe paraqesë karakteristikat e letërsisë antike romake;</p> <p>-t'i njohë karakteristikat e veprës letrare të Virgjilit;</p> <p>-të analizojë përmbajtjen e veprës "Eneida".</p>	<p><b>Virgjili –bio-bibliografia dhe interpretimi i poemës "Eneida"</b></p> <p><b>Nocionet:</b> Poema Miti Historia Bukoliket</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b> Hulumtohen të dhëna për Virgjilin (aq sa janë të njohura). Paraqiten veçoritë themelore të veprës së Virgjilit, duke u ndalë, në mënyrë panoramike, në veprat e tij "Bukoliket" dhe "Gjeorgjiket". Analizohet poema "Eneida", duke u</p>	<p>3.4.1. ta identifikojë tonin solemn dhe frymën liriko-dramtike të poemës "Eneida";</p> <p>3.4.2. ta identifikojë frymën humane dhe iluministe të veprës së Virgjilit;</p> <p>3.4.3. t'i atribuojë, krahasojë dhe vle-</p>



		<p>Gjeorgjiket Eneida Eneu Didona Tema Kronotopi Motivet</p>	<p>ndalë në raportin e saj me “Iliadën” dhe “Odisenë” e Homerit. Nëpërmjet të pyetjeve të parashtruara zbulohen motivet e poemës: motivi patriotik dhe ai erotik. Nëpërmjet të punës në grupe komentohen dhe analizohen pjesë të caktuara të poemës (libri II, II, IV, VII, XII) dhe përshkruhen personazhet kryesore: Eneu dhe Didona. Nxënësve ju jepen sugjerime që impresionet e veta mbi veprën t’i shprehin në një ese.</p> <p><b>Metodat:</b> metoda interpretativo-analitike; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e tekstit (tekst-metoda); metoda e krahasimit; metoda interaktive</p>	<p>rësojë veprimet e personazheve kryesore të poemës;</p> <p>3.4.4. t’i identifikojë pikat e afrimit dhe largimit të “Eneidës” me “Iliadën” dhe “Odisenë” e Homerit;</p> <p>3.4.5. të shkruaj një ese për “Eneidën”, në të cilën gjykimet e veta do të mundohet t’i argumentojë me fakte.</p>
<b>4</b>	<b>Fillimet e letërsisë shqipe dhe periodizimi i saj</b>			
4.1	<p><b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë:</b>  -ta shpjegojë rrugën zhvillimore të letërsisë shqipe, gjegjësisht ta njohë periodizimin e saj;</p>	<p><b>Periodizimi i letërsisë shqipe</b></p> <p><b>Nacionet:</b> Shkrimet e para Humanizmi shqiptar Lletërsia e shek. XVI-XVII</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b> Jepen të dhëna për kulturën shqiptare në mesjetë dhe për fillimin e shkrimit në gjuhën shqipe. Nga nxënësit kërkohet që të hulumtojnë për dokumentet e para</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mundet:</b></p> <p>4.1.1. t’i identifikojë domunetet e para të shqipes së shkruar;</p> <p>4.1.2. ta kuptojë rëndësinë e tyre gju-</p>

	<p>-t`i shpjegojë rrethanat historike dhe shoqërore, në të cilat janë shkruar dëshmitë dhe dokumentet e para të gjuhës shqipe, duke u ndalë në rëndësinë e tyre.</p>	<p>Letërsia e shek. XVIII dhe fillim të shek. XX Letërsia e Rilindjes kombëtare Letërsia shqiptare e periudhes mes dy luftërave botërore Letërsia bashkëkohore</p> <p><b>Fillimet e letërsisë shqipe</b></p> <p><b>Nocionet:</b> Dëshmi dhe dokumente të para të shqipes së shkruar Teksti Bellifortis "Formula e pagëzimit" "Fjalorthi" i Arnold von Harfit "Perikopeja e Ungjellit të Shën Mattheut" Humanistët shqiptarë</p>	<p>shqipe. Nxitet diskutim për karakterin dhe karakteristikat e dokumenteve të para të shkrimit të shqipës. Nxiten nxënësit të mendojnë dhe shprehen në lidhje me mundësinë e një tradite më të lashtë të shkrimit të shqipes, duke u mbështetur në relacionin latinisht të Brokardit. Nxënësit ndahen në grupe dhe kërkohet të shprehin mendimet e tyre rreth rëndësisë historike dhe gjuhësore të këtyre dokumenteve.</p> <p><b>Metodat:</b> metoda e demonstrimit; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e teksti (tekst - metoda); metoda interaktive.</p>	<p>hësore dhe historike;</p> <p>4.1.3. të gjykojë rreth mundësisë së një tradite më të vjetër të shkrimit të shqipes.</p>
4.2	<p>- të njohë kontributin e Marin Barletit dhe rolin që ze ai në kulturën, letërsinë dhe historinë shqiptare;</p> <p>-të fitojë një pasqyrë të përgjithshme për rrethanat shoqëroro-historike, në të cilat është krijuar vepra e Marin Barletit;</p>	<p><b>Marin Barleti –bio-bibliografia</b></p> <p><b>Nocionet:</b> Letërsi e humanizmit "Rrethimi i Shkodrës" "Histori e jëtës dhe bëmave të Skënderbeut, princit të Epirotëve" Biografia Parateksti historik</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b> Prezentohen të dhëna bio-bibliografike për Marin Barletin dhe diskutohet rreth rëndësisë dhe vlerës historike dhe letrare të veprës së tij. Motivohen nxënësit të shprehin mendimet e tyre rreth vendit që zë Barletin në letërsinë dhe historinë shqiptare.</p>	<p>4.2.1. ta përshkruajë jetën e M. Barletit dhe rrethanat në të cilat jetoi dhe veprai ai;</p> <p>4.2.2. t`i numërojë veprat dhe karakteristikat e veprës së Barletit;</p> <p>4.2.3. t`i identifikojë elementet historike dhe ato letrare në veprën e</p>

	<p>-të njihet me strukturën, kompozicioni dhe përmbajtjen e veprës "Rrethimi i Shkodrës";</p> <p>- të bëjë analizë të kryeveprës së Barletit "Historia e jetës dhe bëma-ve të Skënderbeut, princit të Epirotëve";</p> <p>-të njihet më humanistët tjerë më prejardhje shqiptare.</p>	<p><b>Humanistët tjerë më prejardhje shqiptare: Gjon Gazulli, Mikel Maruli, Leonik Tomeu, Maksim Greku dhe Marin Beçikemi</b></p>	<p>Nxënësit nxiten që duke shfrytëzuar njohuritë paraprake mbi figurën e heroit kombëtar, të analizojnë figurën e Skënderbeut sipas veprës së Barletit.</p> <p>Lexohen fragmente nga vepra dhe kërkohet nga nxënësit të identifikojnë elementin historik dhe atë letrar.</p> <p>Hapet diskutim rreth rolit që luan vepra e Barletit në letërsinë shqipe, në përgjithësi dhe vendit që ze ajo si paratekst i rëndësishëm për autorët e mëvonshëm.</p> <p>Jepet një pasqyrë e përgjithshme e humanistëve tjerë me prejardhje shiptare, si: Gjon Gazulit, Mikel Marulit, Leonik Tomeut, Maksim Grekut dhe Marin Beçikemit;</p> <p>Nxënësit motivohen dhe orientohen që mendimet e veta rreth figurës së Skënderbeut, të portetizuar nga Barleti, t`i shprehin nëpërmjet të një ese.</p> <p><b>Metodat:</b> metoda demonstrative; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e tekstit (tekst-metoda);</p>	<p>Barletit;</p> <p>4.2.4. të fitojë një përshtypje të përgjithshme për figurën historike të Skënderbeut dhe këtë përshtypje ta shpreh në një ese.</p>
--	--	---	---	--

			metoda e krahasimit; metoda interaktive.	
5	<b>Humanizmi dhe renesansa në letërsinë evropiane</b>			
5.1	<p><b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë:</b></p> <p>-të identifikojë karakteristikat e humanizmit dhe renesansës në letërsinë evropiane;</p> <p>-ta shpjegojë dhe analizojë strukturën kompozicionale të "Ferrit";</p> <p>-të analizojë tingëllimat e Françesko Petrarkës, novelat e Xhovani Bokaços dhe veprat e Uliam Shekspirit, në frymën e humanizmit dhe renesansës.</p>	<p><b>Humanizmi dhe renesansa –hyrje</b></p> <p><b>Përfaqësuesit e humanizmit dhe renesansës evropiane</b></p> <p>Dante Aligieri "Komedia hyjnore"- pasqyrë e përgjithshme dhe interpretimi i "Ferrit".</p> <p>Françesko Petrarka "Kancioneret"- pasqyrë dhe interpretimi i tingëllimave të zgjedhura</p> <p>Xhovani Bokaço –interpretim i tri novelave të zgjedhura nga "Dekameroni"</p> <p>Uliam Shekspiri –interpretimi i veprës "Hamletit"</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b></p> <p>Paraqiten të dhënat kryesore për përfaqësuesit kryesor të humanizmit dhe renesansës.</p> <p>Bashkë me nxënësit shpjegohen karakteristikat kryesore të humanizmit dhe renesansës, nëpërmjet të veprave të përzgjedhura.</p> <p>Nxënësit njihen me strukturën e "Komedisë hyjnore".</p> <p>Shpjegohet titulli i veprës dhe kuptimi i fjalës <i>komedi</i> dhe fjalës <i>hyjnore</i>.</p> <p>Bashkë me nxënësit shpjegohet pjesa e parë e veprës, "Ferri" dhe përcaktohet struktura dhe kompozicioni i saj.</p> <p>Analizohen motivet e veprës dhe kontekstualizohen në rrethanat e kohës në Itali.</p> <p>Shpjegohet "Dekameroni" dhe struktura e tij dhe jepen instrukcione për lexim të novelave.</p> <p>Jepen shpjegime mbi tingëllimat e</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mundet:</b></p> <p>5.1.1. t` njohë karakteristikat e humanizmit dhe renesansës në një tekst të caktuar;</p> <p>5.1.2.ta njohë strukturën e "Ferrit" të Dantes dhe vlerën e veprës "Komedia hyjnore";</p> <p>5.1.3. të interpretojë fragmente, të analizojë personazhe dhe të përcaktojë temën dhe idenë e veprave të caktuara;</p> <p>5.1.4. t`i interpretojë tingëllimat e Petrarkës dhe t`i dallojë figurat stilistikore;</p> <p>5.1.5. ta shpjegojë kompozicionin dhe strukturën e novelave të Xhovani Bokaços.</p>

			<p>Petrarkës.</p> <p>Nxënësit ndahen në grupe dhe analizojnë tingëllima të ndryshme duke filluar nga kompozicioni, struktura, figurat stilistike.</p> <p>Interpretimi i vargjeve nga grupe të ndryshme është i ndryshëm dhe na shpie drejt përfundimeve, rrjedhën e të cilave e moderon mësimdhënësi.</p> <p>Nxënësit njihen me vepat më të rëndësishme të U. Shekspirit.</p> <p>Nxënësve ju jepen udhëzime që të gjurmojnë informacione për jetën dhe veprën e Shekspirit.</p> <p>Interpretohet tragjedia "Hamleti" dhe komentohet motivi i gjakmarrjes, si motiv që e shtyn Hamletin drejt vetëshkatërrimit.</p> <p><b>Metodat:</b> metoda e interpretimit; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e tekstit (tekst-metoda).</p>	<p>5.1.6. të shpjegojë dhe analizojë tragjedinë "Hamleti" të Shekspirit;</p> <p>5.1.7. të analizojë personazhet e tragjedisë "Hamleti".</p>
<b>6</b>	<b>Letërsia e vjetër shqipe</b>			
6.1	<p><b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë:</b></p> <p>-të njohë rrugën zhvillimore të letërsisë së vjetër shqipe dhe kush-</p>	<b>Letërsia e vjetër shqipe</b>	<p><b>Veprimtaritë:</b></p> <p>Jepen informacione për rrethanat shoqëro-ekonomike dhe kulturore, në të cilat zhvillohet letërsia e vjetër</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mundet:</b></p> <p>6.1.1. të identifikojë tekste nga e letërsia e vjetër shqipe;</p>

	<p>tet shoqëroro-ekonomike të kohës, në të cilën u paraqit ajo;</p> <p>-të njohë karakterin fetar të letërsisë së vjetër shqipe;</p> <p>-të numërojë dhe identifikojë karakterin përkthyes dhe origjinal të letërsisë së vjetër shqipe;</p> <p>- të njohë përfaqësuesit kryesorë të kësaj letërsie.</p>	<p><b>Nacionet:</b>  Letërsi e vjetër  Letërsi e përkthyer  Letërsi origjinale  Karakter fetar  Alfabeti  Transkriptim  Transliterim</p>	<p>shqipe.  Diskutohet rreth karakterit fetar të letërsisë së vjetër shqipe dhe kjo ilustron me shembuj konkret.  Identifikohen pjesë të përkthyer dhe pjesë origjinale nga kjo letërsi.</p> <p><b>Metodat:</b>  metoda e demonstrimit;  metoda e tekstit (tekst metoda);  metoda interaktive.</p>	<p>6.1.2. të shpjegoje dhe komentojë rrethanat në të cilat u paraqit dhe u zhvillua kjo letërsi;</p> <p>6.1.3. të përmend përfaqësuesit më të njohur të kësaj letërsie; të njohë pjesët e përkthyer dhe pjesët origjinale të kësaj letërsie.</p>
6.2	<p>-të njohë veprën “Meshari” të Gjon Buzukut”, si librin e parë të shkruar në gjuhën shqipe;</p> <p>-të shpjegojë dhe interpretojë karakterin e veprës;</p> <p>-të identifikojë gjuhën dhe alfabetin, në të cilin është shkruar vepra.</p>	<p><b>Gjon Buzuku - bio-bibliografia</b></p> <p><b>Nacionet:</b>  Gjon Buzuku  “Meshari”  Kopja e veprës  Karakterin fetar  Zbulimi i veprës  Transliterimi i veprës  Faksimili në origjinal  Lutje  Psallme  Litani  Stili gjysmëgotik  Alfabeti  Dialekti gegë</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b>  Jepen informacione për jetën dhe veprën e Gjon Buzukut dhe vendin e tij në letërsinë dhe kulturën shqiptare.  Lexohen fragmente të transliteruara, që të mund të kuptohet karakteri i veprës.  Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth karakterit të veprës dhe raportit të saj me librat e shenjta.  Analizohet alfabeti i veprës dhe karakteristikat dialektore të saj.  Nxiten nxënësit të mendojnë rreth mundësisë së një letërsie më të vjetër shqipe.</p>	<p>6.2.1. të identifikojë “Mesharin” e Buzukut;</p> <p>6.2.2. të shpjegoje rëndësinë gjuhësore dhe historike të kësaj vepre;</p> <p>6.2.3. të njohë karakterin e saj fetar dhe përkthyes;</p> <p>6.2.4. të kuptojë rëndësinë e kësaj vepre në letërsinë, gjuhën dhe kulturën shqiptare, në përgjithësi.</p>

		Konglomerat përkthimesh	<b>Metodat:</b> metoda e demonstrimit; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e tekstit (tekst metoda).	
6.3	<p>-të njohë kontributin e Lekë Matrëngës dhe veprës së tij "E mbsuame e krishterë" ("Doktrina e Krishterë");</p> <p>-të identifikojë karakterin e veprës, llojin dhe strukturën e saj;</p> <p>-të shpjegojë rolin historik dhe gjuhësor të kësaj vepre, si vepër e parë e shkruar nga një arbëresh dhe si vepër e parë e shkruar në dialektin toskë;</p> <p>-të përcaktojë vendin e Matrëngës si vjershëtor i parë në letërsinë shqipe.</p>	<p><b>Lekë Matrënga-bio-bibliografia</b></p> <p><b>Nacionet:</b> Lekë Matrënga "Doktrina e Krishterë" Arbëresh Përkthim Katekizëm Hyrje Vjershë me tetë vargje Vjershëtori i parë Alfabeti latin Dialekti toskë Njëmbëdhjetërrokësh Poezi e rimuar</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b> Nxënësit nxiten të hulumtojnë material rreth Lekë Matrëngës. Diskutohet rreth vendit që zë Matrënga në letërsinë dhe kulturën shqiptare. Lexohen fragmente dhe komentohen. Diskutohet rreth karakterit ferat të veprës. Nga fragmentet nxiten nxënësit të mendojnë dhe shprehen rreth alfabetit të përdorur dhe dialektit, në të cilin është shkruar vepra. Lexohen dhe komentohen tetë vargjet e njohura të "Këngës së përsërtshme", me të cilën Matrënga njihet si poeti i parë i letërsisë sonë.</p> <p><b>Metodat:</b> metoda e demonstrimit; metoda e monologut dhe dialogut;</p>	<p>6.3.1. të identifikojë veprën e Lekë Matrëngës, duke u nisë nga karakteristikat e saj gjuhësore;</p> <p>6.3.2. të shpjegojë rolin që luan Matrënga në historinë e letërsisë shqipe, si përfaqësuesi i parë i letërsisë që vjen nga një mjedis arbëresh dhe si poeti i parë shqiptar;</p> <p>6.3.3. të shpjegojë karakterin e veprës "Doktrina e krishterë" dhe strukturën e saj (hyrjen, një poezi dhe katekizmin).</p>

			metoda e tekstit (tekst-metoda).	
6.4	<p>-të njohë kontributin e Budit si autor i "Doktrinës së Krishterë";</p> <p>-të njohë rrethanat, në të cilat u botua vepra e Budit;</p> <p>-të shpjegojë karakterin dhe strukturën e "Doktrinës së Krishterë", duke u ndalë veçmas në shtojcën me vjersha fetare shqip, të shkruara në dialektin verior;</p> <p>-të njihet me veprat tjera të Budit;</p> <p>-të shpjegojë vendin e Budit, jo vetëm si përkthyes tekstesh fetare, por edhe si autor i poezisë dhe prozës origjinale;</p> <p>-të identifikojë gjuhën dhe alfabetin e veprave të Budit.</p>	<p><b>Pjetër Budi –bio-bibliografia</b></p> <p><b>Nacionet:</b> Pjetër Budi, "Doktrina e krishterë" "Pasqyra e t`rrefyemit" Rituale Romane Proza e përkthyer Proza origjinale Poezi e përkthyer Poezi origjinale Dialekti gegë Vargu tetërrrokësh</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b> Nxënësit njihen më rrethanat në të cilat u botua vepra e Budit dhe vendin që zë ajo në letërsinë shqipe. Lexohen fragmente nga vepra e Budit dhe nxitet diskutim për karakteristikat gjuhësore, formën dialektore dhe alfabetin e veprës së Budit. Nxënësit ndahen në grupe dhe kërkohet të komentojnë fragmente konkrete.</p> <p><b>Metodat:</b> metoda e demonstrimit; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e tekstit (tekst -metoda); metoda interaktive.</p>	<p>6.4.1. të vlerësojë kontributin e Budit në letërsinë shqipe;</p> <p>6.4.2. të njohë dhe identifikojë veprat e Budit;</p> <p>6.4.3. të shpreh vlerësimin e tij mbi vendin që zë Budi në letërsinë shqipe dhe vlerën e veprës së tij origjinale.</p>
6.5	<p>-të njohë jetën dhe veprën e hartuesit të fjalorit të parë shqip, Frang Bardhit, si vepër e parë pa përmbajtje fetare;</p>	<p><b>Frang Bardhi –bio-bibliografia</b></p> <p><b>Nacionet:</b> Frang Bardhi</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b> Fillimisht nxënësit njohtohen me jetën dhe veprën e Frang Bardhit dhe vendin e tij në kulturën shqiptare, veçmas në gjuhësi dhe folkloristikë.</p>	<p>6.5.1. të identifikojë veprën e Frang Bardhit dhe rëndësinë e saj;</p> <p>6.5.2. të shpjegojë kontributin leksikor, gjuhësor dhe folkloristik të</p>



	<p>-të shpjegojë rëndësinë e fjalorit 238 faqesh latinisht-shqip;</p> <p>-të shpjegojë rëndësinë e shtojcës prej 33 faqesh, me të cilën shoqërohet fjalori dhe sidomos rëndësinë e 113 proverbave dhe fjalëve të urta të përfshira në të;</p> <p>-të shpjegojë arsyet e qarkullimit të mirë të fjalorit të Bardhit.</p>	<p>“Fjalori italisht –shqip” Fjalët e urta dhe proverbat Materiali leksikor Kontributi gjuhësor Kontributi folkloristik</p>	<p>Nëpërmjet të punës në grupe analizohen pjesë nga fjalori. Nëpërmjet punës në grupe dhe punës individuale diskutohet rreth shtojcës, me të cilën shoqërohet fjalori, sidomos me 113 proverbat dhe fjalët e urta, që paraqesin një material të rëndësishëm folkloristik. Nxiten nxënësit të mendojnë dhe shprehen në lidhje me karakteristikat gjuhësore dhe vlerën e veprës së Bardhit, e cila edhe shumë vite pas botimit vazhdon të ketë receptim të mirë.</p> <p><b>Metodat:</b> metoda e demonstrimit; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e tekstit (tekst metoda).</p>	<p>veprës së Bardhit;</p> <p>6.5.3. të përcaktojë vendin e Bardhit në mesin e autorëve të letërsisë së vjetër, si autor i veprës së parë pa elemente fetare.</p>
6.6	<p>-të njohë rrethanat në të cilat u botua vepra e Bogdanit;</p> <p>-të njihet me veprën e autorit më origjinal të letërsisë së vjetër shqipe;</p> <p>-të identifikojë traktatin flozofik të Bogdanit;</p>	<p><b>Pjetër Bogdani - bio-bibliografia</b></p> <p><b>Nacionet:</b> Pjetër Bogdani “Çeta e profetëve” Prozë origjinale Poezi origjinale</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b> Nxënësit njohtohen me rrethanat në të cilat u krijua vepra e Bogdanit dhe me karakteristikat e saj. Diskutohet rreth elementeve origjinale dhe atristike të prozës dhe poezisë së Bogdanit. Nëpërmjet të fragmenteve të përzgjedhura, nxiten nxënësit të disku-</p>	<p>6.6.1. të vlerësojë kontributin e përgjithshëm të P. Bogdanit në historinë, gjuhën dhe letërsinë shqipe;</p> <p>6.6.2. të njohë dhe identifikojë fragmente nga vepra e Bogdanit;</p> <p>6.6.3. të shpjegojë, analizojë dhe ko-</p>

	<p>-të njihet më alfabetin e “Çetës së profetëve” , të botuar në shqip dhe italisht;</p> <p>-të njohë dhe identifikojë tiparet artistike të prozës dhe poezisë së Bogdanit dhe elementet e saj filozofike, teologjike, shkencore.</p>	<p>Alfabeti latin Vepër filozofike Elementet artistike</p>	<p>tojnë rreth leksikut të veprës së Bogdanit dhe tipareve gjuhësore në përgjithësi. Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup do të shpreh mendimet e veta në lidhje me veprën e Bogdanit dhe vendin e saj në letërsinë e vjetër shqipe.</p> <p><b>Metodat:</b> metoda e demonstrimit; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e tesktit(tekst -metoda); metoda interaktive.</p>	<p>mentojë pjesët e përpunuara nga vepra e Bodganit.</p>
6.7	<p>-të njohë, në mënyrë panoramike, përfaqësuesit kryesor të letërsisë arbëreshe të shekullit XVII (Nikollë Brankati, Nikollë Filja);</p> <p>-të njohë kontributin e Jul Varibobës dhe vendin e tij në letërsinë shqipe;</p> <p>-të shpjegojë strukturën dhe veçantitë e përmbledhjes së vjershave e poemave fetare “Jeta e Shën Mërisë Virgjër” të Jul Varibobës”;</p> <p>-të njohë pjesët origjinale dhe pjesët</p>	<p><b>Jul Variboba –bio-bibliografia</b></p> <p><b>Nocionet:</b> Jul Variboba “Jeta e Shën Mërisë Virgjër” Vjersha e poema Pjesë origjinale Pjesë të përkthyer Karakterit fetar Elementet epike Elementet lirike Ngjyrimi lokal Figuracioni</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b> Nxënësve ju jepet informacion për letërsinë arbëreshe të shek. XVIII, duke përmendur emrat e përfaqësuesve kryesor dhe duke u ndalë në jetën dhe veprën e Jul Varibobës. Bashkë me nxënësit analizohet struktura e veprës dhe diskutohet për karakterin fetar të saj. Gjatë analizës ndalemi në fragmente që karakterizohen me ngjyrim lokal. Nxiten nxënësit të mendojnë rreth gjuhës, dialektit dhe barbarizmave në veprën e Varibobës.</p>	<p>6.7.1. të njohë rrethanat në të cilat u krijua vepra e J. Varibobës;</p> <p>6.7.2. të analizojë veprën “Jeta e Shën Mërisë Virgjër ” të Varibobës (karakterin dhe strukturën e saj);</p> <p>6.7.3. të identifikojë pjesët që karakterizohen me ngjyrim lokal;</p> <p>6.7.4 .të përcaktojë vendin e Varibobës në letërsinë shqipe.</p>

	e përkthyerë të veprës, me strukturë jo fort të lidhura;  -të identifikojë gjuhën dhe stilin e veprës së Varibobës.	Karakteristikat gjuhësore Italianizmat Hyrjet e shkruara në prozë	<b>Metodat:</b> metoda e demonstrimit; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e tekstit (tekst-metoda) metoda interaktive.	
7	<b>Klasicizmi në letërsinë evropiane</b>			
7.1	<b>Nxënësi/nxënësja do të jetë aftë:</b>  -të njihet me klasicizmin si formacion stilistikor, kohën dhe vendin e paraqitjes së tij;  -të njihet me parimet teorike të klasicizmit (N.Buallo "Arti poetik");  -të njihet me kultin e të vërtetës dhe të bukurës;  -të identifikojë llojet letrare më të trajtuara nga klasicistët (epopeja, tragjedia, komedia);  -të shpjegojë raportin e letërsisë së klasicizmit me letërsinë antike greke.	<b>Klasicizmi në letërsinë evropiane</b>  <b>Nocionet:</b> Klasicizmi Parimet teorike Llojet letrare të stilit të lartë Llojet letrare të stilit të ulët Imitimi i natyrës E bukura	<b>Veprimtaritë:</b> Nxënësve fillimisht ju ofrohet informacion rreth klasicizmit si formacion stilistikor, rreth kohës dhe vendit të paraqitjes së tij, rreth koncepteve teorike të tij. Nxënësit nxiten që të mendojnë rreth përfaqësuesve më të njohur të klasicizmit. Lexohen fragmente të veprave të njohura klasiciste dhe nëpërmjet tyre mundohemi t'i shpjegojmë karakteristikat e klasicizmit dhe raportin e tij me letërsinë antike greke.  <b>Metodat:</b> metoda e monologut dhe dialogut; metoda e tekstit (tekst-metoda); metoda e krahasimit.	<b>Nxënësi/nxënësja mundet:</b>  7.1.1. të identifikojnë një vepër si vepër klasiciste;  7.1.2. t'i shpjegojë karakteristikat kryesore të klasicizmit;  7.1.3. të njohë përfaqësuesit kryesor të klasicizmit.

7.2	<p>-të shpjegojë jetën dhe veprën e Molierit, si autor që vuri themelet e komedisë klasiciste;</p> <p>-të numërojë komeditë më të njohura të Molierit dhe preokupimet tematike të tyre;</p> <p>-të analizojë komedinë "Tartufi" duke u fokusuar te karakteret dhe mjejet komike.</p>	<p><b>Molieri (Zhan Batist Pokëlen) - bio-bibliografia</b></p> <p><b>Nocionet:</b>  Molieri  Klasicizmi  Rregullat e klasicizmit  Komedia e karaktereve  Komedia e zakoneve  "Tartufi"  "Hipokrizia"  "Mizantropi"  "Kopraci"  "Don Zhuani"  "Borgjezi fisnik"</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b>  Nxënësit fillimisht njihen me jetën dhe veprën e Molierit dhe vendin e saj në letërsinë botërore. Nxënësit ndahen në grupe dhe lexojnë fragmente të zgjedhura nga komedia "Tartufi". Pas leximit të fragmenteve kërkohet nga secili grup që të bëjë analizë të fragmentit të lexuar. Kërkohet nga nxënësit që t'i analizojnë personazhet kryesore të veprës;  Nxiten nxënësit që të shkruajnë një ese në të cilën, duke u mbështetur në komedinë "Tartufi", t'i shprehin mendimet e veta mbi hipokrizinë.</p> <p><b>Metodat:</b>  metoda e demonstrimit;  metoda e monologut dhe dialogut;  metoda e tekstit (tekst-metoda).</p>	<p>7.2.1. të dallojë tiparet klasiciste në veprën e Molierit;</p> <p>7.2.2. të numërojë preokupimet tematike të veprës së Molierit;</p> <p>7.2.3. të analizojë komedinë "Tartufi";  2.4 të analizojë karakteret e komedisë "Tartufi";</p> <p>7.2.5. të përcaktojë vendin e Molierit në letërsinë botërore dhe kontributin e tij në zhvillimin e llojit të komedisë.</p>
8	<p><b>Iluminizmi në letërsinë evropiane dhe atë shqipe</b></p>			
8.1	<p><b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë:</b>  -t'i dallojë tiparet kryesore të ilumi-</p>	<p><b>Iluminizmi në letërsinë evropiane</b>  <b>Iluminizmi në letërsinë shqipe</b></p>	<p><b>Veprimtaritë:</b>  Fillimisht nxënësit njohtohen me rolin që luante "Akademia e re" dhe</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mundet:</b>  8.1.1. të shpjegojë mbi rolin që luajti</p>

	<p>nizmit si drejtim letrar;</p> <p>-të shpjegojë rolin e lëvizjes iluministe shqiptare në emancipimin e përgjithshëm kombëtar;</p> <p>-të njohë përfaqësuesit kryesor të iluminizmit shqiptar: Theodor Kavaliotit, Dhanil Haxhiun dhe Dhaskal Todhrin dhe të analizojnë pjesë nga krijimtaria e tyre.</p>	<p><b>Nacionet:</b>  Voskopoja  Akademia e re  Biblioteka e Akademisë  Iluminizmi evropian  Iluminizmi shqiptar  Arsimimi dhe emancipimi kombëtar</p>	<p>në përgjithësi Voskopoja, si qendër e rëndësishme kulturore e arsimore në emancipimin e përgjithshëm kombëtar shqiptar.</p> <p>Nxënësit njihen me jetën dhe traktatet shkencorë- filozofike të Theodor Kavaliotit dhe rolin që luan ai në "Akademinë e re".</p> <p>Nxënësit njihen me rëndësinë gjuhësore të "Fjalorit greqisht-arumanisht-shqip" të Kavaliotit.</p> <p>Jepen informacione për jetën dhe veprën e Dhanil Haxhiut dhe kontributin e tij në fushën e gjuhësisë.</p> <p><b>Metodat:</b>  metoda e monologut dhe dialogut;  metoda demonstrative.</p>	<p>Voskopoja në ngritjen intelektuale e kulturore shqiptare;</p> <p>8.1.2. t'i numërojë përfaqësuesit më të rëndësishëm të Voskopojës dhe veprat e tyre;</p> <p>8.1.3. të njohë kontributin didaktik dhe gjuhësor të veprës së Theodor Kavaliotit dhe Dhanil Haxhiut.</p>
8.2	<p>-t'i njohë rrethanat, në të cilat u krijua letërsia e bejtejxhinjve;</p> <p>-t'i identifikojë tiparët e letërsisë së bejtenxhinjve dhe ndikimet nga modelet orientale, sidomos nga metrika orientale;</p> <p>-të njohë përfaqësuesit më të rën-</p>	<p><b>Letërsia shqipe me alfabet arabo-turk - Alamiada shqiptare</b></p> <p><b>Nacionet:</b>  Letërsi shqipe me alfabet arabo-turk  Alamiada shqiptare  Ndikimet orientale  Llojet dhe motivet letare  Metrika</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b>  Nxënësit njohtohen me rrethanat shoqërore-ekonomike dhe kulturore, në të cilat u zhvillua letërsia shqipe me alfabet arabo-turk.</p> <p>Nëpërmjet të punës në tekste konkrete identifikohen karakteristikat motivoro-tematike, gjuhësore dhe metrike të kësaj letërsie.</p> <p>Nxënësit motivohen t'i shprehin</p>	<p>8.2.1. të njohë dhe identifikojë letërsinë shqipe me alfabet arabo-turk;</p> <p>8.2.2. të shpjegojë veçoritë e kësaj letërsie dhe rolin e saj;</p> <p>8.2.3. të analizojë veprat më të njohura të kësaj letërsie.</p>

	dësishëm të kësaj letërsie.		<p>mendimet e veta në lidhje me rolin që luan kjo pjesë e letërsisë në zhvillimin e përgjithshëm të letërsisë sonë.</p> <p><b>Metodat:</b>  metoda e demonstrimit;  metoda e monologut dhe dialogut;  metoda e tekstit (tekst-metoda);  metoda e krahasimit.</p>	
8.3	<p>-të njohë krijimtarinë letrare në gjuhën shqipe të Nazim Frakullës;</p> <p>-të numërojë gamën e gjërë të vargjeve të Nazim Frakullës dhe preokupimet tematike të saj;</p> <p>-të identifikojë ndikimet orientale në poezinë e Frakullës;</p> <p>-të përcaktojë vendin e Nazim Frakullës në letërsinë shqipe.</p>	<p><b>Nezim Frakulla –bio-bibliografia</b></p> <p><b>Nocionet:</b> Nazim Frakulla  Divani  Gazele  Motivet  Temat  Figurat stilistike  Karakteristikat gjuhësore  Alfabeti arabo-turk  Barbarizmat</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b>  Jepen informacione për jetën dhe veprën e N. Frakullës dhe vendin e tij në letërsinë shqipe;  Nëpërmjet të leximit të fragmenteve të zgjedhura, nxënësit njohtohen me preokupimet tematike, me metrikën dhe figurat stilistike të poezive të tij.  Kërkohet nga nxënësit që të komentojnë gjuhën e poezisë së N. Frakullës dhe të identifikojnë barbarizmat që përdoren dendur.</p> <p><b>Metodat:</b>  metoda e demonstrimit;  metoda e monologut dhe dialogut;  metoda e tekstit (tekst- metoda);  metoda e krahasimit.</p>	<p>8.3.1. të përcaktojë vendin e Nazim Frakullës në letërsinë shqipe;</p> <p>8.3.2. të analizojë poezinë e tij;</p> <p>8.3.3. të komentojë rreth vlerave artistike të poezisë së Nazim Frakullës;</p> <p>8.3.4. të identifikojë gjuhën e poezisë së Nazim Frakullës.</p>

8.4	<p>-të njohë veprën e Hasan Zyko Kamberit dhe rëndësinë e saj;</p> <p>-të identifikojë preokupimet tematike të poezisë laike të H. Z. Kamberit;</p> <p>-të shpjegojë rolin e “Mevludit “ të Hasan Zyko Kamberit;</p> <p>-të analizojë poezinë “Paraja” që konsiderohet si poezia më e mirë satirike në letërsinë shqipe para shek.XX</p>	<p><b>Hasan Zyko Kamberi bio-bibliografia</b></p> <p><b>Nacionet:</b> Hasan Zyko Kamberi Poezia filozofike, erotike, shoqërore “Mevlud” “Fati im” “Amaneti” “Gjerdeku” “Paraja” Metrika Gjuha Figurat stilistike.</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b> Nxënësve ju jepen shpjegime mbi rrethanat në të cilat u krijua vepra e Hasan Zyko Kamberit dhe vendin e saj në letërsinë shqipe. Nëpërmjet të punës me tekste konkrete, nxënësit nxiten të diskutojnë rreth preokupimeve tematike të poezisë së Hasan Zyko Kamberit rreth metrikës dhe karakteristikave gjuhësore. Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup bën analizën e poezisë “Paraja” (në aspektin përmbajtësor dhe formal). Nxiten nxënësit që sipas udhëzimeve të dhëna, të shkruajnë një ese për poezinë e Hasan Zyko Kamberit (sipas zgjedhjes së tyre).</p> <p><b>Metodat:</b> metoda e demonstrimit; metoda e monologut dhe dialogut; metoda e krahasimit; metoda e tekstit (tekst-metoda); metoda interaktive.</p>	<p>8.4.1. të vlerësojë vendin e Hasan Zyko Kamberit në letërsinë shqipe;</p> <p>8.4.2. të numërojë dhe identifikojë veçoritë e poezisë së Hasan Zyko Kamberit;</p> <p>8.4.3. t`i shpjegojë preokupimet kryesore tematike të poezisë së Hasan Zyko Kamberit;</p> <p>8.4.4. të analizojë disa poezi laike të Hasan Zyko Kamberit (në aspektin përmbajtësor dhe formal).</p>
-----	--	---	---	---

<p>8.5</p>	<p>-të përcaktojë vendin e Kyçyikut në letërsinë shqipe, si autor që shënon kalimin nga poezia klasike e bejtej-xhinjve te poetët e Rilindjes;</p> <p>-të identifikojë karakteristikat gjuhësore të veprës së Kyçyikut;</p> <p>-të njohë Kyçyikun si autor të parë shqiptar të poemës së gjatë;</p> <p>-të analizojë veprat kryesore të Kyçyikut "Erveheja" dhe "Jusufi dhe Zelihaja";</p> <p>-të identifikojë elementet nga Librat e shenjtë (Bibla dhe Kurani) , si paratekste të poemës "Jusufi dhe Zelihaja".</p>	<p><b>Muhamet Kyçiku –bio-bibliografia</b></p> <p><b>Nocionet:</b>  Muhamet Kyçyiku  "Erveheja"  "Jusufi dhe Zelihaja"  Dialekti tosk  Poema e gjatë  Virtyti i femrës  Bibla (Zanafilla 39)  Kurani (sureja 12)  Poezia  "Bekriu"  "Gurbetlitë"</p>	<p><b>Veprimtaritë:</b>  Jepen informacione për jetën dhe veprën e M. Kyçyikut.  Lexohen fragmente nga "Erveheja" dhe nxiten nxënësit të bëjnë analizë të përmbajtjes dhe formës së poemës.  Lexohen fragmente nga "Jusufi dhe Zelihaja" dhe kërkohet nga nxënësit të bëjnë analizë të veprës.  Nxiten nxënësit të mendojnë për paratekstin biblik ose kuranor të poemës "Jusufi dhe Zelihaja".  Nxënësit motivohen dhe udhëzohen që të shkruajnë një ese dedikuar "Ervehesë" ose "Jusufit dhe Zelihasë" (sipas zgjedhjes së tyre).</p> <p><b>Metodat:</b>  metoda e demonstrimit;  metoda e monologut dhe dialogut;  metoda e krahasimit;  metoda e tekstit (tekst- metoda);  metoda interaktive.</p>	<p>8.5.1. të njohë dhe identifikojë veprën e Muhamed Kyçyikut;</p> <p>8.5.2. të shpjegojë rolin që luan vepra e Kyçyikut në letërsinë shqipe;</p> <p>8.5.3. të njohë karakteristikat gjuhësore dhe stilistike të veprës së Kyçyikut;</p> <p>8.5.4. të njohë paratekstin biblik, gjegjësisht kuranor të "Jusufit dhe Zelihasë";</p> <p>8.5.5. të shkruajë një ese për një nga dy poemat e njohura të Muhamet Kyçyikut.</p>
------------	---	--	--	---



<p><b>Notimi i të arriturave të nxënësve</b></p>	<p>Notimi është një proces i vazhdueshëm dhe ka për qëllim të siguron informacione gjithpërfshirëse për të arrituar e nxënësve dhe njëkohësisht t'i përmirëson të njëjtat, gjegjësisht, përparimi dhe notimi i nxënësve i cili monitorohet në vazhdimësi dhe kryhet në kontinuitet gjatë mësimit dhe nënkupton mbledhjen e rregullt të informacioneve të cilat dokumentohen.</p> <p>Notimi i nxënësve ka për qëllim që tua tregojn gjendjen reale të njohurive të tyre dhe t'u jep kahje për përthelimin permanent të mëtutjeshëm. Kriteret për notim arsimtari ua sqaron nxënësve dhe në mënyrë konsistente iu pëmbahet të njëjtave gjatë gjithë vitit shkollor. Instrumentet të cilat kanë të bëjnë me pjesën gojore të notimit dhe vlerësimin të nxënësve mund të jenë me përgjigje të parashtruara nga ana e arsimtarit, pyetje të destinuara para përpunimit të veprës, lekturës, si dhe përmbajtjeve nga gjuha, prezantime gojore të temave të caktuara, sjelljen e mendimeve dhe qëndrimeve në lidhje me parashtrimin e pyetjeve problemore në vepër dhe lekturë, diskutim për veprat letrare në kontekst shoqëror, historik dhe letrar, detyra shtëpie, aktivite dhe angazhim në orë.</p> <p>Instrumentet për notim me shkrim lidhen me punime me shkrim, me teste objektive të njohurive, të shkathësive, veçanarisht me teste dhe ese të pavarura nëpërmjet të cilave nxënësit do ta zbatojnë të mësuarën përmes shprehjes individuale. Nxënësit për të arriturat e tyre marrin notë numerike.</p>
<p><b>Literatura dhe burimet tjera</b></p>	<p>Për realizimin e programit mësimor i domosdoshëm është libër mësimor adekuat dhe doracakë të lejuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe burime tjera elektronike dhe jo elektronike, me përzgjedhje përkatëse sipas lëmive dhe relevancës.</p>
<p><b>Fillimi i implementimit të programit mësimor</b></p>	<p>Viti shkollor 2020/2021</p>
<p><b>Institucioni/bartësi i programit</b></p>	<p>Byroja e Zhvillimit të Arsimit</p>

Nënshkrimi dhe data e miratimit të  
programit mësimor

Потпис и датум на донесување на  
наставната програма

Data e revizionit

nr. \_\_\_\_\_  
viti \_\_\_\_\_

MINISTRE,  
Mila Carovska

\_\_\_\_\_